



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 680/2016**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga :

|                 |            |
|-----------------|------------|
| Gentian Këri    | Kryetar    |
| Spiro Kuro      | Zv/Kryetar |
| Leonard Gremshi | Anëtar     |
| Hektor Balluku  | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 31/08/2016 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me nr. REF-39933-05-30-2016 me objekt “Ndërtim i një ”Data Center” dhe ”Disaster Recovery” ( dublikim të dhënëash) në ambientet e UKT sha” me *fond limit 70,011,675 lekë pa TVSH*, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 23.06.2016 nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, Sh.a

**Ankimues:** “Advanced Business Solutions” sh.p.k.  
*Adresa: Rr. “Papa Gjon Pali II Godina 11 H.1 Ap.19 Tiranë*

**Autoriteti Kontraktor:** Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.a.  
*Adresa: Rruga “5 Maji” pranë Medresesës Tiranë*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë

17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II. Në datën 30.05.2016 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me nr. REF-39933-05-30-2016 me objekt “Ndërtim i një ”Data Center” dhe ”Disaster Recovery” ( dublikim të dhënëash) në ambientet e UKT sha” me fond limit 70,011,675 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 23.06.2016 nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë, Sh.a

II.1 Në datën 06.06.2016 pala ankimuese “Advanced Business Solutions” sh.p.k.ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.1.1 Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor pala ankimuese kundërshton kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike të procedurës së mësipërme të prokurimit. Në mënyrë të përmbledhur pala ankimuese ngren pretendimet se: “[...]”

i. *Objekti i kësaj kontrate është “Ndërtimi i një “Data Center” dhe “Disaster Recovery” (dublikim të dhënash) në ambientet e UKT Sha.. Duke qenë se në këtë procedurë prokurimi kemi të bëjmë me dy objekte të ndryshme, “Data Center” dmth infrastrukturë IT dhe “Disaster Recovery” ( dmth sistem aktiv servera/softëare) si në lloj punimesh të cilat nuk janë të ngjashme me njëra-tjetrën ashtu si dhe në lidhje me kërkesat e veçanta të kualifikimit 9 të cilat duhet të jenë të ndryshme për secilin nga objektet) kërkojmë ndarjen e kësaj procedure në bazë të ligjit në dy lote të ndryshme në mënyrë të tillë që të rrisë konkurrencën midis operatorëve ekonomikë.*

ii. *Në kërkesat e veçanta të kualifikimit kërkohet “te paktën 1 (një) person te certifikuar ne menaxhimin e projekteve PM (Project Management) te vertetuar me çertifikate perkatese. Menaxheri i projektit (pjesë e stafit) duhet të ketë minimumi 5 (pese) vjet eksperience pune në fushën e IT-së, e vërtetueshme me libeze pune; Nuk është përcaktuar qartë siç parashikohet në ligj organi që lëshon këtë certifikatë. Pra nga cili institucion kërkohet kjo certifikatë. Gjithashtu vjetërsia në punë kërkohet të vërtetohet me librezë pune, e cila nuk është dokument që lëshohet nga ndonjë institucion shtetëror por nga punëdhënësi. Gjithashtu kjo kërkesë bie ndesh me vetë mënyrën e kërkuar nga ju për vërtetimin e kësaj pike e cila citoj kërkon: Per te vertetuar kete pike operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim per numrin e punonjesve per periudhen Janar 2016 – Prill 2016, te shoqeruar me listepagesat e çertifikuara nga organet tatimore, shoqeruar me diplomë/çertifikate, CV, kontrata te punës, per profesionet e kerkuara me siper.*

iii. *Në kërkesat e veçanta të kualifikimit është kërkuar: te paktën 3 (tre) Inxhinierë të diplomuar në njerën nga fushat e: Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike ose Teknologji Informacioni, 1(nje) Inxhinier ndertimi dhe 1(nje) Inxhinier/ specialist te certifikuar ne fushen e aspirim/kondicionimeve.te pakten 1 (nje) teknik elektrik te pajisur me certificate per instalim elektrik; Kërkesa juaj për inxhinier ndërtimi nuk ka lidhje me këtë procedurë prokurimi pasi është e pakuptimtë dhe e tepërt. Përse duhet të kërkohet një inxhinier ndërtimi ndërkohë që vet tek specifikimet teknike nga ana juaj janë kërkuar kryerja e punimeve civile ( pa përfshirë instalimet e specializuara). Mos vallë duhet një inxhier ndërtimi për të kryer shembjen e murit. Në kërkesat tuaja të veçanta janë kërkuar tre inxhinier të fushave të inxhinierisë elektronike ose Teknologjisë Informacioni. Në këtë procedurë më shumë se 50 % të zërave në total i zë ndërtimi i “Data Center”. Si është e mundur që nuk është kërkuar asnjë teknik elektrik në momentin që kemi të bëjmë me zëra të tillë si sistem kondicioni, paneli elektrik, tokëzim punime të cilat kërkojnë prezencën e një inxhinieri elektrik dhe atij mekanik. Ju keni kërkuar 1 (një) inxhinier/specialist të certifikuar në fushën e aspirimit/kondicioneve. Në mënyrë të tillë që të mos*

krijojë keqinterpretime ju lutem përcaktoni qartë se çfarë lloji specialisti duhet në lidhje me fushën e aspirimit dhe kondicionimit. Kërkojmë të bëhet: “ Të paktën 3 ( tre) inxhinier të diplomuar në njërin nga fushat; e Inxhinierisë elektronike, inxhinier informatike ose Teknologji Informacioni, 1 (një) inxhinier elektrik dhe 1 ( një) inxhinier Mekanik të certifikuar në fushën e aspirim ( kondicionimeve).

iv. Në KVK është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat vetjake ISO 9001, ISO 18001, ISO 20000, ISO 27001 dhe BS PAS 99:2012. Në lidhje me kërkesën për certifikatë BS PAS 99:2012. Nuk ka standard BS PAS 99:2012 por vetëm BSI PAS 99:2012. Është ky standardi që ju i referoheni? BSI PAS 99:2012 është një standard i ri ndërkombëtar i cili lëshohet nga një i institut i vetëm ndërkohë që në botë ka standarde të tjera të cilat janë ekuivalente me të duke qenë se vetë standardi BSI PAS 99:2012 është një standard i cili përfshin standardet ISO të përcaktuara më sipër. Kjo kërkesë bie në kundërshtim me vetë ligjin pasi ul në mënyrë të ndjeshme konkurrencën midis operatorëve ekonomikë dhe përbën kërkesë certifikimi të dubluar në kërkesat për ISO. Nuk ka asnjë element që mbulon standardi ISO PAS 99:2012 i cili nuk mbulohet standarde e familjes ISO të cilat përdoren në çdo prokurim publik dhe janë referencë për të gjithë botën.

v. Në KVK është kërkuar: të paktën 1 (nje) person të certifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL - Information Technology Infrastructure Library) për menaxhimin e shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit. Për këtë të paraqitet certifikata ITIL - Information Technology Infrastructure Library. Kërkesa juaj për një person të certifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA ( ITIL) për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit është e tepërt pasi ajo nuk ka lidhje me asnjë nga zërat e kërkuar nga ana Juaj.

vi. Në specifikimet e vendosura nga ana juaj për ambientin ku do të ndihet Data Center kërkojmë përcaktimin nga ana juaj të: Ne çfarë kati është dhoma? • Mungon një plan vendosje e pajisjeve që do të jenë në dhomë. Jepen permasat e dhomës por nga ana tjetër kerkohen që të respektohen distancat. Kjo është e pamundur duke marrë parasysh instalimin e të gjithë sistemeve që kerkohen. • So do të kryhet futja e pajisjeve të renda si kondicioner, UPS, etj?• Kerkohet që dhoma të jete dizenuar për të hostuar minimalisht 6 Rack. Me permasat e dhomës 450cmx318cm nuk është e mundur as për 6 Rack duke marrë parasysh se përveç Rack-eve do të ketë edhe pajisje të tjera si kondicionim, panele elektrike, sistem fije zjarri, etj

vii. Në specifikimet teknike të vendosura nga ana Juaj për punimet civile kërkojmë përcaktimin nga juaj të: Punimeve Civile • Ju lutem përcaktoni qartë se çfarë do të përfshihet tek punimet civile?• Ne preventivin e dhënë nga ana juaj është kërkuar FV Veshje e dhomës së serverave me izolues nxehtësie ndërkohe që tek faqja 18 e specifikimeve teknike është kërkuar e) Veshje të dyshemese dhe tavanit me material zjarrdurues. Duke qenë se këto të dyja bien ndesh me njëra tjetren ju lutem përcaktoni qartë se kujt do t'i bëhet veshja me izolues nxehtësie, gjithë dhomes së serverave apo vetëm dyshemese dhe tavanit. • Referuar standarteve të AKSHI:

*Dera duhet te jete e permasave 105 – 120 cm e gjere dhe 240 cm e larte/ Ne document kerkohet qe te jete minimalisht 150cm e gjere dhe nuk jepet lartesi. Duhet te sarktesohet nese pranohet dere sipas standarteve te AKSHI dhe nese duhet qe dera te jete e pajisur me dritare xhami.*

viii. *Në specifikimet teknike të vendosura nga ana Juaj për dyscheme teknologjike Ne faqen 19 te specifikimeve teknike kerkohen: “Ne dy rreshtat ku do te vendosen raket do te jene te permasave 1000x600mm. Ju lutem vini ne dispozicion plan vendosja e pajisjeve per te pare se si eshte menduar konfigurimi I dyshemese. Ne faqen 20 te specifikimeve teknike eshte percaktuar qe Mbrojtja nga Zjarri: materilaet e ndertimit te klases DIN 4102 T1:A2 Zjarrduruese te klases DIN 4102 T2: F30 ose F60. Standartet e vendosura me siper kufizojne shume numrin e prodhuesve te dyschemeve teknologjike. Ju lutem vendosni ne baze te ligjit fjalen EKUIVALENTE per standartet e mesiperme.*

ix. *Në specifikimet e vendosura nga ana Juaj për punimet elektrike kërkohet që furnizimi me energji elektrike i dhmoës të bëhet nga dy linja të pavarura nga kabina kryesore e godinës. Ju lutem përcaktoni nëse këto kablo do të parashikohen nga kontraktuesi apo janë ekzistuese. Nëse po, sa është distanca nga kabina tek panelet elektrike të dhmoës së serverave?*

x. *Ne lidhje me panelet elektrike: Ne specifikimet teknike panelet elektrike kerkohen Redundant Ne faqen 22 te ST Jepet nje skeme elektrike e cila nuk perputhet me kerkesat e dokumentit. Eshte nje skeme me nje burim furnizimi nga e cila furnizohen te gjitha pajisjet. Ne kete skeme eshte paraqitur vetem nje UPS. Pervet te tjerash kjo skeme nuk eshte e sakte persa I perket llogaritjes se numrit te automateve dhe kapacitetit te tyre. (p.sh: Automatet qe furnizojne PDU ne Rack). Ne faqen 22 te ST kerkohen Panele elektrik fuqie, Panel elektrik UPS. Ju lutem përcaktoni per keto dy panele skemen elektrike te sakte dhe pozicionimin e ketyre paneleve ne dhome pasi dhoma konsiderohet mjaft e vogel.*

xi. *Ne lidhje me ndricimin: Faqe 34 e DST jane kerkuar FV Ndricimi Elektrik (Server Room) Kerkohen 8 ndricuesa fluoreshent 2x80Ë (starter elektronik) me shkalle mbrojtje IP45. Ndersa ne planimetri jane 6 cope. Ju lutem përcaktoni qarte se sa duhet te jete numri I sakte I ndricuesve? Per ndricimin emergjent nuk eshte e qarte se si do te realizohet. Nevojitet nje shpjegim me I qarte*

i. *Ne lidhje me UPS: Ligji I prokurimeve publike ka percaktuar qe: Neni 23*

xii. *Specifikimet teknike 5. Specifikimet teknike nuk duhet te kene asnje kerkese apo reference te ndonje marke apo emer te vecante, patente, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipermarres sherbimi pervet rastit kur nuk ekziston nje menyre e mjaftueshme, e sakte apo e kuptueshme e pershrimit te kerkesave, me kusht qe fjalet “ose ekuivalent” te perfshihen detyrimisht ne keto specifikime. Specifikimet teknike te vendosura per UPS bien ne kundërshtim te hapur me ligjin e prokurimeve publike pasi ato jane copy-paste I marre nga Cyber Poëer 6 RMCARD305 Remote Managemet Card. Me poshte eshte link nga te cilat jane marre specifikimet teknike <https://ëëë.cyberpoëersystems.com/products/ups/smart-app->*

online/o16999rt3u Kerkojme Ndryshimin e specifikimeve teknike dhe perpilimi I tyre ne menyre qe te sigurojne konkurrencen e hapur midis operatoreve ekonomike

xiii. Në specifikimet teknike të sistemit ÇTV është kërkuar: eshte kerkuar: Faqe 32 e specifikimeve teknike Sistemi I Monitorimit me Kamera IP kerkohet qe: Gjithashtu ky sistem eshte pergjegjes per monitorimin e: 1. Temperatures 2. Lageshtires 3. Prezences se ujit Si mund te jete e realizueshme monitorimi I (temperatures, lageshtires, prezences se ujit) nepermjet nje sistemi te kamerave? Kerkojme korigjimin e ketij kriteri qe te beje sens logjik dhe te jete i realizueshem.

xiv. Në specifikimet teknike të sistemit të menaxhimit është kërkuar:: Sistemi I menaxhimit Faqe 33 e ST: Pse duhet qe sistemi te jete patjeter me ekran 12.9” me prekje? • Faqe 33 e ST: Pse per nje dhime me siperfaqe 15m2 sistemi iI menaxhimit duhet te jete me mundesi per te lidhur mbi 200 sensore? • Faqe 33 e ST: Kerkohet (sensoret duhet te lidhen me njeri tjetrin dhe me njesine qendrore pa fije dhe ne menyre wireless). Ju lutem cfare nenkuptoni me kete kerkese? • Referuar faqes 32 te ST eshte paraqitur integrimi I sistemit te detektimit dhe fikjes se zjarrit. Sipas ketyre specifikimeve jane shkelur rregullat nderkombetare pasi sistemi I zjarrit eshte nje system shume sensitive ndaj sigurise se ambjentit. Mund te integrohet vetem kontrolli mbi zjarrin nepermjet sensoreve te tymit ashtu si edhe gjendja e alarmit ose pre alarmit, por nuk mund te behet aktivizimi apo caktivizimi I butonave per shuarjen e zjarrit. Kerkojme qe sistemi I zjarrit te mos integrohet ne sistemin e menaxhimit. Ne lidhje me sistemin e menaxhimit mund te integrohen vetem sistemet e detektimit te tymit dhe tre kontakteve per alarmed he prealarmet. •

Referuar faqes 33 te ST: Porte hyrese wireless te njesise qendrore te sistemit te menaxhimit, eshte e paqarte, cfare lloji porte eshte? • Referuar faqes 33, specifikimet: “Procesor Intel Atom 1,6Ghz; 4GB MLC recovery Disc; 1 GB RAM; 2 GB SLC Hard Drive”, Perse eshte e nevojshme qe te kete aftesi programuese, madhesi te RAM dhe Hard drive te ketyre permasave kur sistemi nuk mund t’I kete te nevojshme keto vlera. (keto vlera jane shume specifike dhe I perkasin sistemit te ndodhur ne linkun: <http://ëëë.fibaro.com/en/the-fibaro-system/home-center-2> • Referuar faqes 33: “Mundesi per te integruar pajisje te prodhuesve te trete qe perdorim protokoll komunikimi IP/KNX/zegbee/Zërave”. Keto specifikime kufizojne mundesine per integrimin e paleve te treat qe mund te komunikojne nepermjet protokolleve SNMP ose Modbus. Kerkojme qe te perfshihen edhe pajisje te paleve te treat te tjera qe komunikojne me ane te protokolleve Modbus dhe SNMP. • Specifikimet teknike te Modemi jane marre copy paste nga linku me poshte; <http://ëëë/netpromyanmar.net/index.php/products/product/vieë/5/344.html> Kerkojme nga ana juaj ndryshimin e tyre ne menyre qe te bejne te mundur konkurrencen e hapur midis OE. Perse eshte e nevojshem qe sensori i temperatures te mase temperature deri 100 grade celcius, mund te mjaftohet edhe me 75 grade celcius pasi nuk ka kuptim te arrihet keto limite? Dimensionet e sensorit jane shume specifike: 65x28mm qe te kufizojne ne gjetjen e ketij sensori temperature nga prodhues te ndryshme. Kerkojme heqjen e permasave fikse te sensorit? Saktesia e sensorit te lageshtires eshte shume e vogel (-0.03), perse kerkohet qe te kete nje

saktesi kaq precise? Nderkohe qe pranohen edhe saktesi me te medhaja ne vlere, duke mos cenuar mirefunksionimin e sistemeve ne dhomen e serverave. Punimi I sensorit te ujit ne temperature 100 °C nuk mund te pranohet sepse nuk ka kuptim qe te kete temperature te tilla ne nje dhome serverash, rekomandohet qe temeperatura maksimale e arritur te jete deri ne 24°C. Referuar faqes 33, ku pershkruhet se Njesia Qendrore duhet te monitoroje levizjet nuk eshte e qarte: Se si duhet te behet detektimi I levizjeve, nepermjet kamerave apo nepermjet sensoreve. Gjithashtu cfare kerkohet te behet ne momentin e detektimit te levizjeve.

xv. Në specifikimet teknike të RACK ju lutem përcaktoni: Sa Rack ekzistues janë? Me cfare permasash? Tek specifikimet teknike nuk eshte percaktuar Pika (13. FV Rack -3 (Kater) cope+ aksesore kabllimi (dy per site primar +1 per site sekondar) nderkohe qe tek preventive i punimeve jane kerkuar 2 Rack. Ju lutem percaktoni sa Rack kerkohen 2 cope, 3 cope, 4 cope? Ju lutem percaktoni cfare tipi Rack-u (Dimensionet)

xvi. Sistem alarmi: Në faqen 32 Ne lidhje me Sistemet e Alarmit. Ne faqe 32 te specifikimet teknike kerkohet Sistem Alarmi nderkohe ne Faqen 13 ku eshte tabela permbledhese nuk eshte parashikuar per tu instaluar. Duhet te sakesohet nese do te kete apo jo Sistem Alarmi?

xvii. Sistemi C CTV Ne specifikimet teknike eshte kerkuar Kamerat IP duhet te jene 2MP(1930x1088)pixel, Video Frame Rate- 25fps@1080P, minimuni i aktivizimit te ndricimit IR eshte 0.02Lux/F2.0, 0Lux IR on, Maksimuni I ndricimit IR eshte 30m, Lentja fokale 3.6mm me kend shikimi te pakte 89.9°, te ushqehet me tensin 12v, shkalla e mrojtje IP67-IK10, Procesori te jete 1/2.7" 2Megapixel CMOS-Keto jane specifikime teknike te cilat te gjitha sebashku dhe sidomos Feature 1/2.7" 2Megapixel CMOS, Lentja fokale 3.6mm me kend shikimi shkalla e mrojtje IP67-IK10 i referohet nje brand te vetem qe eshte DAHUA DH-IPC-HDBE4221E(-AS-)-Perse duhet qe kamera te jete IP67 (qe eshte mbrojtja kunder ujit kur kamerat bien ne regjim zhytje ne uje) nderkohe qe kamerat do te instalohen ne ambjentet e brendshme te Data Centerit? Gjithe bota perdor standartin IP66 per kamera outdoor. Ju po kerkoni IP67 per kamera indoor. Kjo eshte nje kerkese disproporcionale me qelimin e perdorimit. Kerkojme: -Ndryshimin e specifikimeve teknike dhe perpilimi i tyre ne menyre qe te sigurojne konkurrencen e hapur midis Operatoreve Ekonomik. -Heqjen e kerkeses per standart IP66 ose zevendesimin e saj me nje standart me te ulet.

xviii. Specifikimet e switch fiber jane copy –paste me Switch D-Link (P/N –DGS-3612G). Specifikimet jane shume te vecanta dhe mundesia qe te kete nje provider tjeter pervec D-Link me te gjitha specifikimet 100% eshte pothuajse e pamundur. <http://www.dlinkmea.com/site/index.php/product/details/294> Ligji i prokurimeve publike ka percaktuar qe: 5. Specifikimet teknike nuk duhet te kene asnje kerkese apo reference te ndonje marke apo emer i vecante, patente, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipermarres sherbimi, pervec rasteve kur nuk ekziston nje menyre e mjaftueshme, e sakte apo e kuotueshme, e pershkrimi te kerkeseve, me kusht qe fjalet “ose ekuivalent” te perfshihen deyrimisht ne keto specifikime. Specifikimet teknike te vendosura per Switch Fibre bien ne

kundeshtim te hapur me lighin e prokurimeve publike pasi ato jane copy/paste i marre nga D-Link me te gjitha specifikimet 100% dhe eshte pothuajse e pamundur te merren nga nje tjetër prodhues.<http://ëëë.dlinkmea.com/site/index.php/product/details/294-Ndryshimin> e specifikimeve teknike dhe perpilimi I tyre ne menyre qe te sigurojne konkurrencen e hapur midis Operatoreve Ekonomik.

xix. Tek specifikimet teknike te zerit 22 dhe 23 te preventivit. Tek specifikimet teknike te zerit 22 dhe 23 te preventivit eshte kerkuar qe CPU te jete Minimumi 4 CPU 175030 dhe Minimum 2 CPU 16180-Kerkojme sqarim se kujt I referoheni me shifrat e percaktuara 175030 dhe 16180? Benchmarkut apo eshte parameter procesori?

xx. Tek shërbimi Software ju lutem sqaroni: .”Transferimi i te dhenave do te kryhet ne momentin qe serverat qendror te database eshte bere Virtualizimi I Serverave te Siperpermendur” Duhet te sqarohet nese Virtualizimi I Serverave do te behet nga kompania apo nga vete Autoriteti Kontraktor. 2. Te pikat ku pershkruhet mirembajtja mujore, ne piken “e” thuhet “Te kryje mirembajtje proactive”. Ju lutem sqaroni cfare nenkuptoni me mirembajtje proactive dhe cfare perfshihet ne te?

xxi. Sistemi HVAC. Kerkohet Sistemet Ngrohje/Ventilim/Kondicionim (HVAC) Kerkohet sistemi i kondicionimit/ajrimit (HVAC) do te kete fuqi konsumi minimalisht 5-5.4 KË per shkak se per kete dhome nevojitet nje kondicioner me i madhe se ceshte percaktuar me poshte (kapacitetit total te ftohjes, nga 5.4 kË ne 6kW) athere edhe kapacitetit konsumit te energjise do te ndryshoje. - Tek specifikimet teknike eshte kerkuar qe secila perj njesive duhet te jete e pajisur me 2 kompresore spiral si me poshte: Kompresore te mund te jene spiral por jo spiral dixhital sepse ky lloj (digital scroll) eshte copy write i Emerson. Duke qene se ligji I prokurimeve publike ndalon dhenien e specifikimeve teknik te cilat te cojne drejt nje brand te vetem kerkojme heqjen e kerkeses per (digital scroll) Tek specifikimet teknike kerkohet qe: Ushqimi per cdo njesi duhet te jete 230V, 1 fazor, 50Hz. Per shkak se kondicioni nevojitet kapacitet me i madh se cfare eshte kerkuar atehere edhe ushqimi duhet me i madh. 400V/3Ph/50HZ Tek specifikimet teknike percaktohet qe: Cdo qark ftohes duhet te kete valvulen e zgjerim termal, filtrimin e thate, depozite per lengun ftohes, valvulen kyce te sigurise. Kompresori duhet te jete i montuar mbi nje bazament per te parandaluar transmetimin e dridhjeve tek njesia. Cdo qark ftohes duhet te jete i lidhur e nje kondensator qe mund te kontrollohet ne distance dhe te jete i lidhur me instalimin e kondensatorit. Largesia maksimale 50 meter. Ne kete pike nuk percaktohet madhesia dhe volumi i depozites per lengun e ftohesit. Duhet te dihet edhe lartesia ndermjet njesise se jashtme dhe asaj te brendshme. Kerkojme te sqarohen si me poshte: A) Faqe 22 e ST kerkohet: Sistem ngrohje/ventilim/kondicionim (HVAC) Kerkohet system ngrohje/ventilim/kondicionim apo system ftohje percizionit te larte? B) Faqe 22: (Autoriteti Kontraktues) ka perlllogaritur qe sistemi i kondicionimit/ajrimit (HVAC) do te kete nje fuqi konsumi minimalisht 5-5.4 KË; C) Faqe 23: Kerkohet certificate Testimi per kondicionimin. Kjo certificate jepet nga fabrika pasi eshte prodhuar pajisja. A do te pranohet ne ofertim vetem Deklarate Konformiteti? D) Sa eshte kapaciteti ftohes ne kË I nje pajisje? E) Sa eshte

*nxehtesia qe clirojne pajisjet ekzistuese?F) A kerkohet system ventilimi per dhomen?G) Ku eshte menduar te vendoset kondensuesi I kondicionerit?H) Sa eshte distance nga kondicioner tek kondensuesi?I) Sa eshte disniveri (lartesia) ndermjet kondicionerit dhe kondensuesit?Per sa me siper, sqarojme se sistemi i kondicionimit/ajrimit (HVAC) do te kete fuqi konsumi minimalisht 5-5.4KË sic eshte specifikuar ne faqen 22. Kompresoret duhet te jene spiral dhe redundant, me ushqim per cdo njesi 230V, 1 fazor 50Hz. [...]”.*

II.2. Në datën 15.06.2016 me anë të shkresës nr.13335/1 Prot, datë 15.06.2016 autoriteti kontraktor i kthen përgjigje palës ankimuese duke pranuar pjesërisht ankesën për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.2.1 Në kthimin e përgjigjes autoriteti kontraktor argumenton se : “[...]”

i. Në lidhje me kërkesën tuaj për ndarjen e procedurës së prokurimit në lote. Procedura e prokurimit qe do te zhvillohet nga ana jone me objektin dhe fondin limit të përcaktuar më lart, ne baze te Nenit 3, pika 8 te Ligjit te prokurimit Publik, eshte klasifikuar si procedurë prokurimi për punë, për arsye të vëllimit kryesor të zënë nga volumi i punës në raport me zërin e mallrave dhe sherbimeve te cilat do kryhen. Duke pasur parasysh objektin e tenderit "Ndërtim i një "Data Center" dhe "Disaster Recovery" (dublikim të dhënash) në ambientet e UKT sh.a.", si edhe Shtojcen 12 te kesaj DST, do te vini re qe kjo procedure përmban punime civile dhe vendosje sistemesh elektronike si dhe vendosjen dhe instalimin e hardëare dhe softëare. Pikërisht se autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë një data center dhe disaster recovery, është vlerësuar teknikisht që kjo procedurë të realizohet me një lot dhe kontrata të nënshkruhet me një operator ekonomik fitues. Vetëm në këtë mënyrë ne si autoritet kontraktor mund të sigurohemi që do të përfitojmë 100 % objektin e procedurës së prokurimit.Në rast se e marrim për të mirëqenë pretendimin tuaj dhe e ndajmë këtë procedurë prokurimi në dy lote dhe konkretisht: Lot 1 "Ndërtim i një "Data Center"; Lot 2 "Disaster Recovery", probablisht do të kemi dy fitues e rrjedhimisht mund të hasim shumë probleme në implementimin e realizimin e kësaj procedure. Ju sqarojmë se problemi kryesor që mund të lindë në këtë situatë do të ishte moskompatibiliteti teknik midis: produktit Data Center që do të ofrohet nga operatori ekonomik fitues i këtij loti (Kompania A) me produktin disaster recovery që do të ofrohet nga operatori ekonomik fitues i lotit tjetër (Kompania B) e në këtë situatë kjo do të conte në mënyrë të pashmangshme në dështimin e procedurës. Neni 1 i Ligjit të Prokurimit Publik sanksionon: "Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Referuar pikës 1 të ankesës tuaj, ku ju pretendoni se janë dy objekte të ndryshme e rrjedhimisht kërkon ndarjen në lote, ju sqarojmë se (pavarësisht se autoriteti jonë nuk e ka parashikuar si të tillë) neni 26, pika 2, gërma b) i VKM nr. 914 datë 29.12.2014 sanksionon se kontratat për Punë mund të prokurohen edhe me celesa në dorë, ndërkohë që në një prokurim të kësaj natyre ka dy elementë: a) natyra e punëve përfshin një gamë jashtëzakonisht të gjerë punimesh dhe b) kontrata zhvillohet me një lot e rrjedhimisht lidhet vetëm me një operator ekonomik. Përsa mësipër, duke qenë se autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet 100 % për

realizimin e kësaj procedure prokurimi, vlerëson se ndarja në lote e kësaj procedure do të vinte në vështirësi teknike realizimin me sukses të kontratave nga operatorët që do të rezultonin fitues të dy loteve të ndryshme të cilët do të ofronin produkte të ndryshme e probablisht mund të ishin dhe jo kompatibel me njeri tjetrin. Rrjedhimisht kjo do të conte në dështim të sigurt të procedurës së prokurimit duke cënuar parimet e Qëllimit të Ligjit Prokurimit Publik. Gjithashtu, ju sqarojmë se ndarja në lote, sic kërkohet nga ana juaj në ankesë do të cënonte rëndë parimin e transparensës dhe të barazisë në tendera të parashikuara në Nenin 1 dhe 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Kjo procedurë prokurimi duke ju referuar Shtojcës 12 të DST perfshin punimë dhe shërbime. Ne vijim te sa mesiper, vlerësojmë se me te drejte nga autoriteti kontraktor janë kërkuar kritere të parashikuara në nenet 26 dhe nenit 28 të VKM Nr 914, datë 29/12/2014 pika 5 a)b)c). Madje në vetë Udhëzuesin e Agjencisë së Prokurimit Publik për Autoritetet Kontraktore, ndarja e kontratës në lote për të shmangur kërkesat ligjore të përcaktuara për procedurat e prokurimit mund të konsiderohet shkelje e parimeve të transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, ose ofertuesve potencialë në procedurat e prokurimit publik. Nga ana tjetër, ligjvënësi ka të parashikuar në nenet 74 dhe 75 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, opsionin e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Në mënyrë që të rritet pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, secili prej ofertuese mund të përzgjedhë nënkontraktorë për kryerjen e një pjese të punimeve që kërkohen ose të hyjë në Bashkime të Përkohshme të Operatorëve Ekonomikë. Për rrjedhojë ky pretendim i juaji nuk merret në konsideratë.

iii. Në lidhje me ankesën për kriterin e përcaktuar në Shtojcën 10, pika 2, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 10 të punësuar në të cilët të përfshihen specialistet me kualifikimet e mëposhtme: të paktën 1 (një) person të certifikuar në menaxhimin e projekteve PM (Project Management) të vërtetuar me certifikatë përkatëse. Menaxheri i projektit (pjesë e stafit) duhet të ketë minimumi 5 (pese) vjet eksperience pune në fushën e IT-së, e vërtetueshme me libereze pune. Përsa i përket pretendimit tuaj se duhet përcaktuar se “cili institucion e lëshon këtë certifikatë”, autoriteti Kontraktor ka kërkuar vetëm që ky person të jetë i certifikuar në menaxhimin e projekteve PM. Pra, në këtë rast certifikata mjafton të jetë e njohur zyrtarisht dhe i lëshuar nga një institucion i njohur. Përcaktimi siç kërkoni ju i institucionit që do të lëshonte certifikatën do të ishte diskriminues dhe do të kufizonte pjesëmarrjen e atyre operatorëve ekonomikë që e plotësojnë këtë kriter me certifikatën përkatëse për personin e certifikuar në menaxhimin e projekteve PM. Në bazë të Nenit 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, (LPP) i ndryshuar: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë

kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” Duke qenë se mund të ekzistojnë shumë institucione publike apo privatë të cilat certifikojnë individët për menaxhimin e projekteve, vendosja e disa prej tyre dhe përjashtimi i të tjerëve, kur ato plotësojnë të njëjtat kritere, do të vinte në kundërshtim me Nenin 1 të LPP Në këtë mënyrë, sqarojmë së Autoriteti Kontraktor ka vepruar në përputhje me përcaktimet e Nenit 46 të LPP dhe Neneve 26 e 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’. Në lidhje me pretendimin tuaj se vjetërsia në punë nuk mund të provohet me librezën e punës por me listpagesat e certifikuara, për të provuar përvojën 5 vjecare në fushën e IT, ju sqarojmë se listpagesat e paraqitura provojnë vetëm faktin që “Menaxheri i Projektit” punon aktualisht pranë operatorit ekonomik ofertues, por jo përvojën e tij të mëparshme dhe vjetërsinë në punë, pasi në cdo rast ky individ mund të ketë punuar në një “kompani” apo “institucion” tjetër dhe vitet e punës pranë këtyre “punëdhënësve” nuk mund të figurojnë në listpagesat aktuale të shoqërisë ofertuese në procedurën e prokurimit publik. Pretendimi juaj se ky kriter kualifikimi bie në kundërshtim me kërkesën “Per te vertetuar kete pike operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim per numrin e punonjesve per periudhen Janar 2016 – Prill 2016, te shoqeruar me listepagesat e certifikuara nga organet tatimore, shoqeruar me diplomë/certifikate, CV, kontrata te punës, per profesionet e kerkuara me sipër”, nuk është e bazuar pasi kjo kërkesë ligjore vetëm sa e përforcon kriterin për vjetërsinë në punë të kërkuar për personin e certifikuar në menaxhimin e projekteve PM, gjë e cila mund të vërtetohet me librezën e punës, por jo me listpagesat e certifikuar nga organet tatimore, pasi e rithkesojmë këto listpagesa pasqyrojnë vetëm punëmarrësit aktualë të ofertuesve dhe nuk vërtetojnë vjetërsinë e tyre në punë, për vitet e mëparshme të punës. Baza ligjore ku mbeshteten keto kritere eshte e ndryshme. Ne perputhje me Nenin 26, pika 8, germa “b” te VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, sanksionohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose”Ne perputhje me Nenin 28, pika 5, germa “b” te VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, sanksionohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla” Ndërkohë, ne perputhje me nenin 28, pika 5, germa “c” te VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku sanksionohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:“dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”Po keshtu qellimi i parashikimit te ketyre kerkesave eshte i ndryshem, pasi: Eksperienca individuale e Menaxherit te Projekteve lidhet ngushtesisht me eksperiencen dhe aftesite individuale te tij, te cilat duhet te implementohen ne realizimin e kesaj procedure

prokurimi, nderkohe qe kerkesa per listpagesat per periudhen e kerkuar, lidhet me fuqine mesatare te nevojshme te punonjesve (pra numri total) qe kerkohen per realizimin e kesaj procedure prokurimi. Libreza e Punës është dokument personal (pasaporta e punës) i punëmarrësit, ndërsa punëdhënësi vetëm e plotëson atë, por ky dokument shoqëron punëmarrësin në cdo marrëdhënie punë që ai krijon. Për rrjedhojë ky pretendim i juaji nuk merret ne konsideratë.

iv. Në lidhje me ankesën tuaj për kriterin e përcaktuar në Shtojcën 9, pika 2, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, 2.3.3 Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij minimalisht 10 te punesuar ne te cilet te perfshihen specialistet me kualifikimet e meposhteme • te paktën 3 (tre) Inxhinierë të diplomuar në njerën nga fushat e: Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike ose Teknologji Informacioni, 1(nje) Inxhinier ndertimi dhe 1(nje) Inxhinier/specialist te certifikuar ne fushen e aspirim/kondicionimeve. Në shtojcën 12 të DST përcaktohet qartë se zërat e punimeve përfshijnë “punime civile për Server Room”. Ky zë kërkon patjetër trajtimin e punimeve nga persona të specializuar, pra inxhinier ndërtimi, sic është kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim në DST. Pretendimi juaj se inxhinieri i ndërtimit nuk ka lidhje me këtë procedurë prokurimi, nuk mbështetet në specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Duke qenë se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar kryerjen e punimeve civile, përmbushja e kësaj kërkesë kërkon persona të specializuar për ta kryer këtë punim, e për rrjedhojë ky kriter është në përputhje të plotë me Nenin 46 të LPP dhe Nenin 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, si dhe në bazë të Nenit 23 të LPP: Sqarojmë, gjithashtu se kërkesa për 1 inxhinier ndërtimi është në përputhje të plotë me Nenin 46 të LPP, pasi është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet, dhe për të cilën operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Në vazhdim, në lidhje me pretendimin se “nuk duhet të jetë një teknik elektrik, por një inxhinier elektrik”, Autoritetit Kontraktor ka gjykuar dhe vlerësuar se vendosja e kriterit “për 1 (një) teknik elektrik të pajisur me certifikatë për instalime elektrike” i plotëson nevojat dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor për përmbushjen e zërave të kontratës dhe plotësimin e specifikimeve teknike. Kriteri, sic e kërkon ju të ndryshohet, “për një inxhinier elektrikt”, do të kufizonte pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi duke pakësuar konkurrencën dhe duke ndikuar në barazinë e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik. Nga ana tjetër, në ankesën tuaj, ju nuk argumentoni se përse zërat si paneli elektrik, instalime elektrike, tokëzime etj., nuk mund të kryhen nga një teknik elektrik dhe duhet patjetër një inxhinier elektrik. Autoriteti Kontraktor gjykon që kërkesa/kriteri për kualifikim për 1 (një) teknik elektrik të pajisur me certifikatë për instalime elektrike” është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe jo diskriminues. Në lidhje me kriterin për një 1 (një) inxhinier/specialist në fushën e aspirim/kondicionimeve, kriteri është mjaft i qartë. Autoriteti Kontraktor kërkon një inxhinier/specialist në fushën e kondicionimeve të certifikuar për të kryer këto shërbime dhe ky

kriter nuk krijon asnjë keqinterpretim, pasi ky kriter do të quhet i plotësuar nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, mjafton që ai të ketë një person të punësuar, qoftë inxhinier apo specialist të certifikuar për sistem e aspirimit dhe kondicionimit. Referuar shtojcës 12 të DST, si dhe Specifikimeve Teknike, ju bëjme me dije se për realizimin e kontratës për këtë procedurë nuk ka të parashikuar asnjë ze që mund të kerkojë pervojen apo aftësitë teknike të një inxhinieri mekanik. Duke qene se kjo procedure nuk parashikon punime apo shërbime të kësaj natyre, bazuar në nenet 26 dhe 28 të VKM nr. 914, si dhe në përputhje me parashikimet e nenit 46 të Ligjit “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, vlerësojmë se kjo kërkesë nuk është në përputhje me natyrën e kontratës. Për rrjedhojë ky pretendim i juaji nuk merret në konsideratë.

v. Në lidhje me ankesën tuaj përse i përket Shtojcës 10, pika 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, paragrafi 2.3, Kapaciteti teknik, pika 2.3.2 është kërkuar si kriter i veçantë kualifikimi “Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat vetjake ISO 9001, ISO 18001, ISO 20000, ISO 27001 dhe BS PAS 99-2012”, ku kërkon heqjen e BSI PASS 99-2012, sqarojmë se: Duke analizuar kërkesën për certifikatë “BS PAS 99-2012”, Autoriteti Kontraktor mendon se kjo është një certifikatë e domosdoshme, në mënyrë që operatori ekonomik t’i provojë Autoritetit Kontraktor se ai zotëron një sistem të integruar menaxhimi të suksesshëm dhe eficient, në të gjitha elementët e aktivitetit të tij, përfshirë menaxhimin e cilësisë, mjedisit, sigurisë, etj. Në ndryshim nga sa pretendoni ju në ankesën tuaj, “BS PAS 99-2012”, është një certifikim i mirëfilltë ku integrohen shumë sisteme të menaxhimit dhe jo një udhëzues për integrimin e standardeve të ndryshme brenda një kompanie. Duke vlerësuar punët e kërkuara në këtë procedurë prokurimi, specifikimet teknike të përcaktuara në DST, rëndësinë parësore që ka ndërtimi i një “Data Center” dhe “Disaster Recovery”, përse i përket nivelit të sigurisë dhe kërkesave të mbrojtjes dhe funksionalitetit të këtij sistemi, kërkesa për kualifikim për certifikatën “BS PAS 99-2012” është kusht thelbësor për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës, brenda parametrave të kërkuara në DST. Në vazhdim, duke ju referuar procedurës për marrjen e certifikatës “BS PAS 99-2012”, kjo është një procedurë normale, e cila nuk paragjykon apo diskriminon asnjë kompani dhe është e hapur për çdo person, që kundrejt aplikimeve përkatëse, ta përfitojë këtë certifikatë. Në ankesën tuaj, ju pretendoni se vendosja e një kriteri të tillë është diskriminuese, por për të mbështetur këtë pretendim nuk paraqisni asnjë fakt apo provë, që të provojë se kriteri për certifikatën “BS PAS 99-2012”, përbën diskriminim dhe trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë. Autoriteti kontraktor siç u theksua dhe më lart, sqaron se kjo është një certifikatë që mund të merret nga çdo kompani, që ushtron aktivitetin e saj tregtar në mënyrë të rregullt, sigurisht pasi të jenë përmbushur disa standarte të caktuara, të cilat në rastin konkret përputhen plotësisht me natyrën e kontratës objekt prokurimi. Për rrjedhojë ky pretendim i juaji nuk merret në konsideratë.

vi. Në lidhje me ankesën tuaj përse i përket Shtojcës 10, pika 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, paragrafi 2.3, Kapaciteti teknik, pika 2.3., ku është kërkuar si kriter i veçantë kualifikimi “te paktën 1 (një) person të certifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL

- Information Technology Infrastructure Library) për menaxhimin e shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit. Për këtë të paraqitet çertifikata ITIL - Information Technology Infrastructure Library, sqarojmë se: Duke ju referuar Shtojcës 12 të DST si dhe Specifikimeve Teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, i gjithë procesi i kërkuar në këtë procedurë prokurimi bazohet në Ligjin nr. 10 325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “Administrimi i Sistemit të bazave të të dhënave Shtetërore” dhe VKM-në nr. 710, datë 21 gusht 2013, “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”. Respektimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore të parashikuara në këto akte, kërkon domsdoshmërisht mirëmbajtjen e këtij sistemi që do të ndërtohet nëpërmjet personave/kompanive të certifikuar dhe të aftë ta kryejnë këtë proces. Për këtë arsye Autoriteti Kontraktor kërkon me shumë të drejtë që në fazën e kualifikimit të ofertave të vlerësojë nëse operatorët ekonomikë ofertues e realizojnë këtë detyrim për përmbushjen me sukses të kontratës. Sipas Specifikimeve Teknike, pika 11 (faqe 14), Afati Kohor i Implementimit të Projektit është përcaktuar “Mirëmbajtje SLA 2 vjet”. Gjithashtu në pikën 9, “Mirëmbajtja”, kërkohet “Mirëmbajtja do të përfshijë shërbimet periodike sipas manualeve të pajisjeve dhe riparimin pa kosto në rastet e defekteve”. Duke qenë se autoriteti kontraktor, si ze me vete të objektit të kësaj procedure prokurimi ka parashikuar edhe mirëmbajtjen, rrjedhimisht vlerësojmë se kriteri i sipërkerkuar: “1 (nje) person të certifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL – Information Technology Infrastructure Library) për menaxhimin e shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit” është në përputhje me natyrën e kontratës. Ju bejme me dije se në rast se ky kriter nuk do të kërkohej në DST atëherë autoriteti kontraktor e ka të vështirë të realizojë pjesën fundore të procedureve të prokurimit pra mirëmbajtjen e rrjedhimisht do të detyrohej të realizonte një procedure me vete prokurimi cka do të shtonte burokracine por edhe kostot e kësaj procedure. Në këto kushte, referuar të gjithë elementëve, natyrës së veçantë të punës dhe zërave konkretë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar, Autoriteti kontraktor, ka gjykuar dhe vlerësuar se vendosja e një kërkesë të tillë për kualifikim është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me natyrën e kontratës, pasi nisur nga rëndësia e të gjithë elementëve të sipërcituar, kjo kontratë mund të përmbushet me sukses nga operatorët ekonomikë që disponojnë këto lloj standarde të certifikimeve. Në ankesën tuaj, ju vetëm ngrini pretendimin që një kriter i tillë kualifikimi “nuk ka lidhje me asnjë nga zërat e kërkuar nga ana juaj”. Ky pretendim është i pabazuar dhe nuk është paraqitur asnjë argument apo provë që të vërtetojë pretendimin tuaj. Përkundrazi bazuar në specifikimet teknike të lidhjeve me këtë procedurë prokurimi ky kriter është i domosdoshëm për realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e saj. Për rrjedhojë ky pretendim i juaj nuk merret në konsideratë.

vii. Në lidhje me kërkesën për specifikimet e vendosura për Ambjentin ku do të ndërtohet Data Center për përcaktimin e:

- Në çfarë kati është dhoma?
- Mungon një plan vendosjeje e pajisjeve që do të jenë në dhomë. Jepen permasat e dhomes por nga ana tjetër kerkohen që të ertespektohen distancat. Kjo është e pamundur duke marrë parasysh instalimin e të gjithë sistemeve që kerkohen.
- So do të kryhet futja e pajisjeve të renda si kondicioner, UPS, etj?•

Kerkoheq qe dhoma te jete dizenuar per te hostuar minimalisht 6 Rack. Me permasat e dhomes 450cmx318cm nuk eshte e mundur as per 6 Rack duke marre parasysh se pervec Rack-eve do te kete edhe pajisje te tjera si kondicionim, panele elektrike, system fikje zjarri, etj Ju sqarojme si me poshte vijon: • Godina eshte ne rikonstrukcion te pjesshem per kete arsye nuk eshte e mundur ti bashkengjisim dokumentave standarte te tenderit planimetrine e objektit. Eshte menduar qe Data Center te jete ne katin e pare te godines, ne momentin fillestar eshte planifikuar qe te vendosen 4 rack (1 ekzistues, 2 te rinj objekt I kesaj procedure dhe 1 RACK rezerve). • Plani i vendosjes se pajisjeve eshte lene i lire per sugjerim te Operatoreve Ekonomik • Per futjen e pajisjeve te renda si kondicioner, UPS etj eshte menduar qe dera te kete permasa me te medha se standarti AKSHI (105-120cm) por te jete 150cm.

viii. Ne lidhje me kerkesen per specifikimet e vendosura per Punimet Civile per percaktimin e:

Punimeve Civile • Ju lutem percaktoni qarte se cfare do te perfshihet tek punimet civile? •

Ne preventivin e dhene nga ana juaj eshte kerkuar FV Veshje e dhomes se serverave me izolues nxehtesie nderkohe qe tek faqja 18 e specifikimeve teknike eshte kerkuar e) Veshje te dyshemesë dhe tavanit me material zjarrdurues. Duke qene se keto te dyja bien ndesh me njera tjetren ju lutme percaktoni qarte se kujt do ti behet veshja me izolues nxehtesie, gjithe dhomes se serverave apo vetem dyshemesë dhe tavanit. • Referuar standarteve te AKSHI: Dera duhet te jete e permasave 105 – 120 cm e gjere dhe 240 cm e larte/ Ne document kerkoheq qe te jete minimalisht 150cm e gjere dhe nuk jepet lartesi. Duhet te saktsohet nese pranohet dera sipas standarteve te AKSHI dhe nese duhet qe dera te jete e pajisur me dritare xhami.

Ne lidhje me kete pretendim, ne dokumentat standarte te tenderit eshte shprehur qarte qe punimet civile perfshijne sa me poshte: a) Shëmbje muri; b) Demontim; c) Mbyllje hermetike të dritareve; d) Derë kundra zjarrit; e) Veshje të dyshemesë dhe tavanit me materjal zjardurues; f) Lyerja e dyshemesë me material izolues si dhe mureve deri ne lartësine 30 cm; g) Bazamentë për kondicionimin; h) Bazamentë për kondesatorët; i) Bazamentë për UPS-të; Veshje e dyshemesë dhe tavanit me materjal zjardurues eshte pjese e punimeve civile nderkohe qe zeri nr.10 i preventivit F.V Veshje e dhomes se Serverave me Izolues nga Nxehtesia perfshin vec te tjerave: Muret dhe ndarjet perreth Server Room-it do te jene ne gjendje te sigurojne izolim ndaj zhurmave mbi 40db dhe rezistente ndaj zjarrit deri ne 60 min. Ofertuesi do te instaloje nje dera aksesit te bollshme (te pakten 1.5m gjeresi) me karakteristikat e meposhtme: a) Dritare xhami sigurie EN12600 Type B b) Zjarrdurues per 60 minuta; c) Me kycje elektromagnetike dhe mekanizem ristartimi; d) Ne rast nderprerje te energjise, te jete ne gjendje te hapet mekanikisht nga brenda Server Room-it pa patur nevojën e kartave te hyrjes apo energjise; Dera eshte kerkuar me permasa 150 cm per te lejuar lehtesimin e futjes se pajisjeve te renda dhe njesive te infrastruktures.

viii. Ne lidhje me pretendimin per specifikimet e vendosura per Dyshemene Teknologjike; Ne faqen 19 te specifikimeve teknike kerkohen: “Ne dy rreshtat ku do te vendosen raket do te jene te permasave 1000x600mm. Ju lutem vini ne dispozicion plan vendosja e pajisjeve per te pare se si eshte menduar konfigurimi I dyshemesë. Ne faqen 20 te specifikimeve teknike eshte percaktuar

qe Mbrojtja nga Zjarri: materilaet e ndertimit te klases DIN 4102 T1:A2 Zjarrduruese te klases DIN 4102 T2: F30 ose F60. Standartet e vendosura me siper kufizojne shume numrin e prodhuesve te dyshemeve teknologjike. Ju lutem vendosni ne baze te ligjit fjalen EKVIVALENTE per standartet e mesiperme. Ne lidhje me kete pretendim sqarojme se, plani i vendosjes se pajisjeve eshte lene ne dore te Operatorit Ekonomik. Ne rast se ka paqartesi eshte e mundur te kryhen vizita prane objektit deri ne momentin e hapjes se ofertave. Persa me siper ne baze te LPP Neni 23 pika 5, shtohet fjala “OSE EKVIVALENTE” per standartet e siperpermendura.

x. Ne lidhje me pretendimin per specifikimet e vendosura per Punimet Elektrike. Kerkohet qe furnizimi me energji elektrike I dhomes te behet nga dy linja te pavarura nga kabina kryesore e godines. Ju lutem percaktoni nese keto kablllo do te parashikohen nga kontraktuesi apo jane ekzistuese? Nese po, sa eshte distance nga kabina tek panelet elektrike te Dhomes se Serverave. Ne lidhje me kete pretendim sqarojme se, linjat e furnizimit dhe kabllot perkatese deri tek dhoma e serverit do jene ekzistuese.

xi. Ne lidhje me panelet elektrike: Ne specifikimet teknike panelet elektrike kerkohen Redundant Ne faqen 22 te ST Jepet nje skeme elektrike e cila nuk perputhet me kerkesat e dokumentit. Eshte nje skeme me nje burim furnizimi nga e cila furnizohen te gjitha pajisjet. Ne kete skeme eshte paraqitur vetem nje UPS. Pervet te tjerash kjo skeme nuk eshte e sakte persa I perket llogaritjes se numrit te automateve dhe kapacitetit te tyre. (p.sh: Automatet qe furnizojne PDU ne Rack). Ne faqen 22 te ST kerkohen Panele elektrik fuqie, Panel elektrik UPS. Ju lutem percaktoni per keto dy panele skemen elektrike te sakte dhe pozicionimin e ketyre paneleve ne dhome pasi dhoma konsiderohet mjaft e vogel. Ne lidhje me kete pretendim sqarojme se skema e panelit eshte e sakte, redundanca do te behet nepermjet linjave paralele me change-over ekzistues.

xii. Ne lidhje me ndricimin: Faqe 34 e DST jane kerkuar FV Ndricimi Elektrik (Server Room)

Kerkohen 8 ndricues fluoreshent 2x80W (starter elektronik) me shkalle mbrojtje IP45. Ndersa ne planimetri jane 6 cope. Ju lutem percaktoni qarte se sa duhet te jete numri I sakte I ndricuesve? Per ndricimin emergjent nuk eshte e qarte se si do te realizohet. Nevojitet nje shpjegim me I qarte. Persa i perket sistemit te furnizim vendosje ndricim elektrik, duke ju referuar projektit (figures) ndricuesi 9 eshte ndricimi i emergjences.

xiii. Ne lidhje me UPS: Ligji I prokurimeve publike ka percaktuar qe: Neni 23

Specifikimet teknike 5. Specifikimet teknike nuk duhet te kene asnje kerkese apo reference te ndonje marke apo emer te vecante, patente, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipermarres sherbimi pervet rastit kur nuk ekziston nje menyre e mjaftueshme, e sakte apo e kuptueshme e pershrimit te kerkesave, me kusht qe fjalet “ose ekuivalent” te perfshihen detyrimisht ne keto specifikime. Specifikimet teknike te vendosura per UPS bien ne kundërshtim te hapur me ligjin e prokurimeve publike pasi ato jane copy-paste I marre nga Cyber Poër 6 RMCARD305 Remote Managemet Card. Me poshte eshte link nga te cilat jane marre

specifikimet teknike <https://ëëë.cyberpoëersystems.com/products/ups/smart-app-online/o16999rt3u> Kerkojme Ndryshimin e specifikimeve teknike dhe perpilimi I tyre ne menyre qe te sigurojne konkurrencen e hapur midis operatoreve ekonomike. Ne lidhje me kete pretendim sqarojme se, ne baze te ligjit LPP Neni 23 pika 5, shtohet fjala “OSE EKUIVALENTE” per standartet e siperpermendura.

xiv. Ne lidhje me specifikimet teknike te sistemit ÇTV ku eshte kerkuar: Faqe 32 e specifikimeve teknike Sistemi I Monitorimit me Kamera IP kerkohet qe: Gjithashtu ky sistem eshte pergjegjes per monitorimin e: 1. Temperatures 2. Lageshtires 3. Prezences se ujit Si mund te jete e realizueshme monitorimi I (temperatures, lageshtires, prezences se ujit) nepermjet nje sistemi te kamerave? Kerkojme korigjimin e ketij kriteri qe te beje sens logjik dhe te jete i realizueshem. Grupi i punës gjykon te arsyeshme heqjen e ketij kriteri, duke marre parasysh pretendimet e mesiperme te operatorit ekonomik ankimues.

xv. Ne lidhje me specifikimet teknike te sistemit te menaxhimit ku eshte kerkuar: Sistemi I menaxhimit • Faqe 33 e ST: Pse duhet qe sistemi te jete patjeter me ekran 12.9” me prekje? •

Faqe 33 e ST: Pse per nje dhime me siperfaqe 15m2 sistemi I menaxhimit duhet te jete me mundesi per te lidhur mbi 200 sensore? • Faqe 33 e ST: Kerkohet (sensoret duhet te lidhen me njeri tjetrin dhe me njesine qendrore pa fije dhe ne menyre ëireless). Ju lutem cfare nenkuptoni me kete kerkese? • Referuar faqes 32 te ST eshte paraqitur integrimi I sistemit te detektimit dhe fikjes se zjarrit. Sipas ketyre specifikimeve jane shkelur rregullat nderkombetare pasi sistemi I zjarrit eshte nje system shume sensitive ndaj sigurise se ambjentit. Mund te integrohet vetem kontrolli mbi zjarrin nepermjet sensoreve te tymit ashtu si edhe gjendja e alarmit ose pre alarmit, por nuk mund te behet aktivizimi apo caktivizimi I butonave per shuarjen e zjarrit. Kerkojme qe sistemi I zjarrit te mos integrohet ne sistemin e menaxhimit. Ne lidhje me sistemin e menaxhimit mund te integrohen vetem sistemet e detektimit te tymit dhe tre kontakteve per alarmed he prealarmet. • Referuar faqes 33 te ST: Porte hyrese ëireless te njesise qendrore te sistemit te menaxhimit, eshte e paqarte, cfare lloji porte eshte? •

Referuar faqes 33, specifikimet: “Procesor Intel Atom 1,6Ghz; 4GB MLC recovery Disc; 1 GB RAM; 2 GB SLC Hard Drive”, Perse eshte e nevojshme qe te kete aftesi programuese, madhesi te RAM dhe Hard drive te ketyre permasave kur sistemi nuk mund t’I kete te nevojshme keto vlera. (keto vlera jane shume specifike dhe I perkasin sistemit te ndodhur ne linkun: <http://ëëë.fibaro.com/en/the-fibaro-system/home-center-2> • Referuar faqes 33: “Mundes

per te integruar pajisje te prodhuesve te trete qe perdorim protokoll komunikimi IP/KNX/zegbee/Zëave”. Keto specifikime kufizojne mundesine per integrimin e paleve te treat qe mund te komunikojne nepermjet protokolleve SNMP ose Modbus. Kerkojme qe te perfshihen edhe pajisje te paleve te treat te tjera qe komunikojne me ane te protokolleve Modbus dhe SNMP. • Specifikimet teknike te Modemi jane marre copy paste nga linku me poshte; <http://ëëë/netpromyanmar.net/index.php/products/product/vieë/5/344.html> Kerkojme nga ana juaj ndryshimin e tyre ne menyre qe te bejne te mundur konkurrencen e hapur midis OE. Perse eshte e nevojshem qe sensori i temperatures te mase temperature deri 100 grade celcius,

mund te mjaftohet edhe me 75 grade celcius pasi nuk ka kuptim te arrihet keto limite? Dimensionet e sensorit jane shume specifike: 65x28mm qe te kufizojne ne gjetjen e ketij sensori temperature nga prodhues te ndryshme. Kerkojme heqjen e permasave fikse te sensorit? Saktesia e sensorit te lageshtires eshte shume e vogel (-0.03), perse kerkohet qe te kete nje saktesi kaq precise? Nderkohe qe pranohen edhe saktesi me te medhaja ne vlere, duke mos cenuar mirefunksionimin e sistemeve ne dhomen e serverave. Punimi I sensorit te ujit ne temperature 100 °C nuk mund te pranohet sepse nuk ka kuptim qe te kete temperature te tilla ne nje dhome serverash, rekomandohet qe temperatura maksimale e arritur te jete deri ne 24°C. Referuar faqes 33, ku pershkruhet se Njesia Qendrore duhet te monitoroje levizjet nuk eshte e qarte: Se si duhet te behet detektimi I levizjeve, nepermjet kamerave apo nepermjet sensoreve. Gjithashtu cfare kerkohet te behet ne momentin e detektimit te levizjeve. Ne lidhje me kete pretendim sqarojme se: -Sistemi eshte menduar me madhesi 12.9" me prekje qe te jete i dukshem dhe praktik ne perdorim. -Sistemi i menaxhimit duhet te kete mundesi per te lidhur mbi 200 sensore per siperfaqen 15 m2, pra eshte lapsus. Ishte 2000 sensore Behet 200 sensore -Sensorete duhet te lidhen me njeri tjetrin dhe me njesine qendrore ne menyre eireless per arsyen qe te mos jete e nevojshme instalimi i sistemit te kabllimit per sensoret dhe per te lejuar riorganizim te lehte te mbulimit me sensore ne te ardhmen. -Kerkesa qe sistemi i fikjes se zjarrit te mos integrohet ne sistemin e menaxhimit pranohet megjithese sistemi i menduar e suporton kete karakteristike. Ishte Integrim i sistemit te dedektimit dhe fikjes se zjarrit. Behet Integrim i sistemit te dedektimit te zjarrit. -Porte hyrese eireless do te thote porte komunikimi eireless per te lejuar komunikimin me sensoret. -Specifikimet jane kerkuar te permasave qe lejojne performance sa me te larte te sistemit. -Shtohet fjala "ose ekuivalent" sipas ligjit. -Shtohet fjala "ose ekuivalent" sipas ligjit. -Sensori i temperatures eshte kerkuar te mase temperature deri 100 grade celcius per te lejuar sensorin te dergoje informacion edhe ne kushtet e nje zjarri te mundshem. -Pranohet kerkesa per heqjen e permasave te sensorit. -Pranohet kerkesa per heqjen e saktetise se sensorit te lageshtires duke lejuar saktesine deri sa te lejohet mirefunksionimi i sistemeve ne dhomen e serverave. -Dedektimi i levizjeve do te behet nepermjet kamerave te cilat bejne snapchat ne momentin e levizjes. Ky snapchat mund te dergohet per njoftim me email gjithashtu mund te perdoret per sinkronizim me sistemin e aksesit me ane te databazes.

xvi. Ne lidhje me specifikimet teknike te RACK ku kerkoni te percaktohen: Sa Rack ekzistues jane? Me cfare permasash? Tek specifikimet teknike nuk eshte percaktuar Pika (13. FV Rack -3 (Kater) cope+ aksesore kabllimi (dy per site primar +1 per site sekondar) nderkohe qe tek preventive i punimeve jane kerkuar 2 Rack. Ju lutem percaktoni sa Rack kerkohen 2 cope, 3 cope, 4 cope? Ju lutem percaktoni cfare tipi Rack-u (Dimensionet)? Persa me siper sqarojme se RACK-et do jene RACK Serverash 42U. Sasia do jete 4 rack (1 ekzistues), 2 te rinj, objekt i kesaj procedure dhe 1 RACK reserve (ekzistues).

xvii. Ne lidhje me Sistemet e Alarmit. Ne faqe 32 te specifikimet teknike kerkohet Sistem Alarmi nderkohe ne Faqen 13 ku eshte tabela permbledhese nuk eshte parashikuar per tu instaluar.

Duhet te saktesohet nese do te kete apo jo Sistem Alarmi?Per sa me siper, sqarojme se Sistemi i alarmit eshte kerkese per kete procedure prokurimi, dhe se eshte kerkuar te jete pjese integrale e sistemit te menaxhimit.

xviii. Ne lidhje me Sistemin ÇTV.Ne specifikimet teknike eshte kerkuarKamerat IP duhet te jene 2MP(1930x1088)pixel,Video Frame Rate- 25fps@1080P, minimuni I aktivizimit te ndricimit IR eshte 0.02Lux/F2.0, 0Lux IR on,Maksimuni I ndricimit IR eshte 30m,Lentja fokale 3.6mm me kend shikimi te pakte 89.9°,te ushqehet me tensin 12v,shkalla e mrojtje IP67-IK10,Procesori te jete 1/2.7" 2Megapixel CMOS-Keto jane specifikime teknike te cilat te gjitha sebashku dhe sidomos Feature 1/2.7" 2Megapixel CMOS, Lentja fokale 3.6mm me kend shikimi shkalla e mrojtje IP67-IK10 i referohet nje brand te vetem qe eshte DAHUA DH-IPC-HDBE4221E(-AS-)-Perse duhet qe kamera te jete IP67 (qe eshte mbrojtja kunder ujit kur kamerat bien ne regjim zhytje ne uje) nderkohe qe kamerat do te instalohen ne ambjentet e brendshme te Data Centerit?Gjithe bota perdor standartin IP66 per kamera outdoor.Ju po kerkoni IP67 per kamera indoor.Kjo eshte nje kerkese disproporcionale me qelimin e perdorimit.Kerkojme:-Ndryshimin e specifikimeve teknike dhe perpilimi i tyre ne menyre qe te sigurojne konkurrencen e hapur midis Operatoreve Ekonomik.-Heqjen e kerkeses per standart IP66 ose zevendesimin e saj me nje standart me te ulet. Ne lidhje me pretendimet e mesiperme sqarojme se, kriteret e vendosura nuk jane diskriminuese dhe plotesohen nga disa firma dhe prodhues boteror. Kjo e verifikueshme edhe me nje kerkim te thjeshte ne Google. Nderkohe qe standarti IP67 eshte standart nga ne i kerkuar. Për rrjedhojë ky pretendim i juaji nuk merret ne konsideratë.

xix. Ne lidhje me specifikimet e sëitch fiber.Specifikimet e sëitch fiber jane copy –paste me Sëitch D-Link (P/N –DGS-3612G).Specifikimet jane shume te vecanta dhe mundesia qe te kete nje provider tjeter pervec D-Link me te gjitha specifikimet 100% eshte pothuajse e pamundur.<http://ëëë.dlinkmea.com/site/index.php/product/details/294>Ligji i prokurimeve publike ka percaktuar qe: 5.Specifikimet teknike nuk duhet te kene asnje kerkese apo reference te ndonje marke apo emer i vecante, patente, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipermarres sherbimi, pervec rasteve kur nuk ekzisotn nje menyre e mjaftueshme, e sakte apo e kuotueshme, e pershkrimi te kerkeseve, me kusht qe fjalet “ose ekuivalent” te perfshihen deyrimisht ne keto specifikime.Specifikimet teknike te vendosura per Sëitch Fibre bien ne kundesthim te hapur me lighin e prokurimeve publike pasi ato jane copy/paste i marre nga D-Link me te gjitha specifikimet 100% dhe eshte pothuajse e pamundur te merren nga nje tjeter prodhues.<http://ëëë.dlinkmea.com/site/index.php/product/details/294>-Ndryshimin e specifikimeve teknike dhe perpilimi I tyre ne menyre qe te sigurojne konkurrencen e hapur midis Operatoreve Ekonomik.Persa me siper ne baze te ligjit LPP Neni 23 pika 5, shtohet fjala “OSE EKVIVALENTE” per standartet e siperpermendura.

xx. Ne lidhje me specifikimet teknike te zerit 22 dhe 23 te preventivit.Tek specifikimet teknike te zerit 22 dhe 23 te preventivit eshte kerkuar qe CPU te jete Minimumi 4 CPU 175030 dhe

Minimum 2 CPU 16180-Kerkojme sqarim se kujt I referoheni me shifrat e percaktuara 175030 dhe 16180?Benchmarkut apo eshte parameter procesori? Grupi i punes sqaron se, tek zeri 22 dhe 23 i preventivit shifrat e mesiperme i referohen Benchmarkut dhe modifikohen si me poshte: ISHTE: 175030; BEHET: BENCHMARK 17503

xxi. Ne lidhje me sherbimin Softëare.Tek Sherbimi Softëare ju lutem sqaroni1.”Transferimi i te dhenave do te kryhet ne momentin qe serverat qendror te database eshte bere Virtualizimi I Serverave te Siperpermendur”Duhet te sqarohet nese Virtualizimi I Serverave do te behet nga kompania apo nga vete Autoriteti Kontraktor.2.Te pikat ku pershkruhet mirembajtja mujore, ne piken “e” thuhet “Te kryeje mirembajtje proactive”.Ju lutem sqaroni cfare nenkuptoni me mirembajtje proactive dhe cfare perfshihet ne te?Persa me siper grupi i punes gjykon se specifikimet teknike jane mese te qarta mbi kerkesat qe ka autoriteti kontraktor mbi transferimin e te dhenave dhe mirembajtjen.

xxii. Ne lidhje me sistemin HVAC. Kerkohet Sistemet Ngrohje/Ventilim/Kondicionim (HVAC)Kerkohet sistemi i kondicionimit/ajrimit (HVAC) do te kete fuqi konsumi minimalisht 5-5.4 KË per shkak se per kete dhome nevojitet nje kondicioner me i madhe se ceshte percaktuar me poshte (kapacitetit total te ftohjes, nga 5.4 kË ne 6kË) athere edhe kapacitetit konsumit te energjise do te ndryshoje.-Tek specifikimet teknike eshte kerkuar qe secila perj njesive duhet te jete e pajisur me 2 kompresore spiral si me poshte:Kompresore te mund te jene spiral por jo spiral dixhital sepse ky lloj (digital scroll) eshte copy ërite iEmerson. Duke qene se ligji I prokurimeve publike ndalon dhenien e specifikimeve teknik te cilat te cojne drejt nje brand te vetem kerkojme heqjen e kerkeses per (digital scroll)Tek specifikimet teknike kerkohet qe:Ushqimi per cdo njesi duhet te jete 230V,1 fazor,50Hz. Per shkak se kondicioni nevojitet kapacitet me I madh se cfare eshte kerkuar atehere edhe ushqimi duhet me I madh. 400V/3Ph/50HZ Tek specifikimet teknike percaktohet qe: Cdo qark ftohes duhet te kete valvulen e zgjerimir termal, filtrimin e thate, depozite per lengun ftohes, valvulen kyce te sigurise. Kompresori duhet te jete I montuar mbi nje bazament per te parandaluar transmetimin e dridhjeve tek njesia. Cdo qark ftohes duhet te jete I lidhur e nje kondensator qe mund te kontrollohet ne distance dhe te jete I lidhur me instalimin e kondensatorit. Largesia maksimale 50 meter.Ne kete pike nuk percaktohet madhesia dhe volumi I depozites per lengun e ftohesit. Duhet te dihet edhe lartesia ndermjet njesise se jashtme dhe asaj te brendshme.Kerkojme te sqarohen si me poshte:A) Faqe 22 e ST kerkohet: Sistem ngrohje/ventilim/kondicionim (HVAC) Kerkohet system ngrohje/ventilim/kondicionim apo system ftohje percizionit te larte?B)

Faqe 22: (Autoriteti Kontraktues) ka perlllogaritur qe sistemi I kondicionimit/ajrimit (HVAC) do te kete nje fuqi konsumi minimalisht 5-5.4KË;C) Faqe 23: Kerkohet certificate Testimi per kondicionimin. Kjo certificate jepet nga fabrika pasi eshte prodhuar pajisja. A do te pranohet ne ofertim vetem Deklarate Konformiteti?D) Sa eshte kapaciteti ftohes ne kË I nje pajisje?E) Sa eshte nxehtesia qe clirojne pajisjet ekzistuese?F) A kerkohet system ventilimi per dhomen?G) Ku eshte menduar te vendoset kondensuesi I kondicionerit?H) Sa eshte distance nga kondicioner tek kondensuesi?I) Sa eshte disniveli (lartesia) ndermjet

*kondicionerit dhe kondensuesit? Per sa me siper, sqarojme se sistemi i kondicionimit/ajrimit (HVAC) do te kete fuqi konsumi minimalisht 5-5.4KË sic eshte specifikuar ne faqen 22. Kompresoret duhet te jene spiral dhe redundant, me ushqim per cdo njesi 230V, 1 fazor 50Hz. ..*

II.4. Në datën 17.06.2016 pala ankimuese ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor. Në ankesën e dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, operatori ekonomik ankimues ka hequr dorë nga pretendimet e ngritura pranë autoritetit kontraktor me numër rendor 12,13,17,18,19

II.5. Në datën 30.06.2016 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e parë të palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se “[...]Objekti i kësaj kontrate është “Ndërtimi i një “Data Center” dhe “Disaster Recovery” ( dublikim të dhënash) në ambientet e UKT Sha.. Duke qenë se në këtë procedurë prokurimi kemi të bëjmë me dy objekte të ndryshme, “Data Center” dmth infrastrukturë IT dhe “Disaster Recovery” ( dmth sistem aktiv servera/softëare) si në lloj punimesh të cilat nuk janë të ngjashme me njëra-tjetrën ashtu si dhe në lidhje me kërkesat e veçanta të kualifikimit 9 të cilat duhet të jenë të ndryshme për secilin nga objektet) kërkojmë ndarjen e kësaj procedure në bazë të ligjit në dy lote të ndryshme në mënyrë të tillë që të rrisë konkurrencën midis operatorëve ekonomikë..[....]”Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 9 pika 5 të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave përcaktohet se: “Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor”.

III.1.2. Në nenin 3 “Përkufizime” pika 7 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Mall” është çdo gjë materiale me vlerë ekonomike.”

III.1.3. Në nenin 3 “Përkufizime” pika 6, 8 dhe 9 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “6. “Kontrata publike furnizimi” janë

kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Një kontratë publike, që ka objekt furnizimin me mallra dhe që përfshin në mënyrë dytësore edhe vendosjen dhe instalimin, vlerësohet si “kontratë publike furnizimi”, nëse vlera e mallrave e tejkalon vlerën e vendosjes apo instalimit.

8. “Kontratat për punë publike” janë kontratat publike, që kanë objekt realizimin, projektimin dhe realizimin e punimeve apo të punës ose realizimin me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me kërkesat e përcaktura nga autoriteti kontraktor”

9. “Punim” është përfundimi i ndërtimit ose i veprave civile, që përmbushin një funksion ekonomik ose teknik.

III.1.4. Në shtojcën 13 “Preventivi i Punimeve”, autoriteti kontraktor ka parashikuar kryerjen e punimeve si më poshtë vijon:

| <b>NR</b> | <b>PËRSHKRIMI</b>                                                                    | <b>NJËSIA</b> | <b>SASIA</b> | <b>CMIMI PA TVSH</b> |
|-----------|--------------------------------------------------------------------------------------|---------------|--------------|----------------------|
| 1         | Punime Civile për Server Room                                                        | Njësi         | 1            |                      |
| 2         | FV Dysheme teknologjike                                                              | M2            | 15           |                      |
| 3         | FV Panele elektrik fuqie, përfshi intalimet elektrike të pajisjeve në Server Room,   | Njësi         | 1            |                      |
| 4         | FV Sistem Kondicionimi                                                               | Copë          | 1            |                      |
| 5         | FV Rrjeti Elektrik (Kabllime,Kanaline Metalike, Tokezimi,Kuti Shperndarese Energjie) | Copë          | 1            |                      |
| 6         | FV Sistemi Akses Control                                                             | Njësi         | 1            |                      |
| 7         | FV Sistemi mbrojtje zjarri dhe fikje me gaz                                          | Njësi         | 1            |                      |
| 8         | FV Sistem Kamerash                                                                   | Njësi         | 1            |                      |
| 9         | FV PDU te monitorueshme perfshire edhe sensoret e temperatures dhe lageshtise        | Copë          | 4            |                      |
| 10        | FV Veshje e dhomes se Serverave me izolues nxehtesia                                 | Copë          | 1            |                      |
| 11        | Sistemi i Menaxhimit                                                                 | Copë          | 1            |                      |
| 12        | FV Sistem Ndricimi per Dhomen e serverave                                            | Copë          | 1            |                      |
| 13        | FV Rack                                                                              | Copë          | 2            |                      |
| 14        | FV Pajisje e tipit tape library per backup                                           | Copë          | 1            |                      |
| 15        | FV Pajisje e tipit storage per Sistemin                                              | Copë          | 2            |                      |
| 16        | FV Pajisje siguri ne rrjet                                                           | Copë          | 2            |                      |
| 17        | FV Sëitch Ethernet                                                                   | Copë          | 4            |                      |

|    |                                                                             |      |     |  |
|----|-----------------------------------------------------------------------------|------|-----|--|
| 18 | FV Sëitch Fiber                                                             | Copë | 4   |  |
| 19 | FV Server per bazen e te dhenave te tipit RDBMS te Sistemit                 | Copë | 2   |  |
| 20 | Ëindoës Server 2012 Standart R2                                             | Copë | 10  |  |
| 21 | Microsoft windows Exchange                                                  | Copë | 400 |  |
| 22 | FV Server per aplikimin e Sistemit                                          | Copë | 2   |  |
| 23 | FV Server per bazen e te dhenave te tipit RDBMS te Sistemit (Siti Sekondar) | Copë | 1   |  |
| 24 | FV Server per aplikimin e Sistemit (Siti Sekondar)                          | Copë | 1   |  |
| 25 | FV UPS 6KVA (Siti Sekondar)                                                 | Copë | 1   |  |
| 26 | FV UPS 30KVA me 30 min pavarësi                                             | Copë | 2   |  |
| 27 | Sherbime Softëare                                                           | Copë | 1   |  |
| 28 | Mirembajtje                                                                 | Vite | 2   |  |
|    | <b>Totali</b>                                                               |      |     |  |

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrative, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka kategorizuar kontratën e mësipërme të prokurimit si kontratë “*Punë Publike*”. Referuar aktit administrative nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 “*Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik*”, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se “*Në lidhje me kërkesën tuaj për ndarjen e procedurës së prokurimit në lote. Procedura e prokurimit që do të zhvillohet nga ana jone me objektin dhe fondin limit të përcaktuar më lart, në baze të Nenit 3, pika 8 të Ligjit të prokurimit Publik, është klasifikuar si procedurë prokurimi për punë, për arsye të vëllimit kryesor të zënë nga volumi i punës në raport me zërin e mallrave dhe shërbimeve të cilat do kryhen. Duke pasur parasysh objektin e tenderit “Ndërtim i një “Data Center” dhe “Disaster Recovery” (dublikim të dhënash) në ambientet e UKT sh.a.”, si edhe Shtojcën 12 të kësaj DST, do të vini re që kjo procedure përmban punime civile dhe vendosje sistemesh elektronike si dhe vendosjen dhe instalimin e hardware dhe software.” Referuar kërkesës së autoritetit kontraktor për furnizimin me pajisjet e sipërkuara, *prima facie*, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka parashikuar nevojën e furnizimit me pajisje të teknologjisë së informacionit ( hardware,) si edhe ofrimin e shërbimeve të lidhura me to si edhe mirëmbajtjes për një periudhë kohore dy vjeçare. Në funksion të realizimit të synimit të autoritetit kontraktor “Data Center dhe Disaster Recovery”, konstatohet se janë parashikuar kryerja e disa punimeve civile në funksion të realizimit të objektit të kontratës. Referuar aktit administrative nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 “*Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik*”, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se “*Përsa mësipër, duke qenë se autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet 100 % për realizimin e kësaj procedure prokurimi, vlerëson se ndarja në lote e kësaj procedure do të vinte në vështirësi**

teknike realizimin me sukses të kontratave nga operatorët që do të rezultojnë fitues të dy loteve të ndryshme të cilët do të ofronin produkte të ndryshme e probablisht mund të ishin dhe jo kompatibel me njeri tjetrin”. Sa më sipër, për një gjykim të drejtë të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes nga njëra anë dhe pretendimeve të autoritetit kontraktor nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test balancues proporcionaliteti. Në lidhje me parimin e proporcionalitetit të parashikimit të mësipërm, K.P.P. gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të tre elementëve kryesorë. Së pari nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin dhe së treti në rast se ndarja në lote, ose zbatimi i dy procedurave të veçanta (punimet civile dhe furnizim vendosje të paisjeve të TIK dhe mirëmbajtja e tyre çënojnë interesin e autoritetit kontraktor në cilësinë e një enti publik. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është arritja e qëllimit të tij përmes procedurës së prokurimit objekt ankimi- ndërtimi *Data Center dhe Disaster Recovery*”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se referuar shtojcës 13 “*Preventivi i Punimeve*”, konstatohet se janë parashikuar si punime civile ashtu edhe furnizime të paisjeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe shërbime të lidhura me këto të fundit. K.P.P. gjykon se për shkak të vetë specifikës që gëzojnë shërbimet e lidhura me TIK dhe natyrës së veçantë të këtyre të fundit, stafi i specializuar, dëshmia e eksperiencës së mëparshme janë të një natyre krejt të ndryshme nga punimet civile dhe sa më sipër, të dy procedurat nuk mund të jenë të lidhura në një të vetme. Në rastin konkret K.P.P. gjykon se do të ndodheshim para rastit klasik të diskriminimit të operatorëve ekonomikë të cilët gëzojnë eksperiencë në fushat specifike (ndërtime civile- TIK) duke mos nxitur konkurrencën duke rënë ndesh me parashikimet e nenit 1 dhe 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar. Në lidhje me pretendimin e autoritetit kontraktor se “*omisiss... autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet 100 % për realizimin e kësaj procedure prokurimi, vlerëson se ndarja në lote e kësaj procedure do të vinte në vështirësi teknike realizimin me sukses të kontratave omisiss...*” – Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 “*Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës*” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit/shërbimeve apo punëve do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Sa më sipër referuar testit të proporcionalitetit të sipërcituar, K.P.P. gjykon se ndarja në lote e procedurës së prokurimit ose në dy procedura të veçanta nuk çënon interesin e autoritetit kontraktor në cilësinë e entit publik. K.P.P. gjykon se për shkak të natyrës së veçantë të dy fushave të mësipërme, zbatimi i tyre veçmas nuk çënon garancinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, garanci për të cilën ky i fundit është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës/ave.

III.1.6. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimet e palës ankimuese qëndrojnë ndaj dhe procedura e mësipërme e prokurimit duhet të ndahet në dy lote të veçanta ose në dy procedura të veçanta. Të ndodhur në këto, kushte, K.P.P. gjykon se procedura e mësipërme e prokurimit duhet anuluar, në zbatim të nenit 64, pika 2 gërma “ç” dhe nenit 24 gërma “dh” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parshikon se “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji dhe në ripublikimin e saj autoriteti kontraktor të ndajë procedurën e mësipërme në dy lote ose në dy procedura të veçanta.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se “[...]Kërkesat e veçanta të kualifikimit kërkohet “te paktën 1 (një) person te certifikuar ne menaxhimin e projekteve PM (Project Management) te vertetuar me çertifikate perkatese. Menaxheri i projektit (pjesë e stafit) duhet të ketë minimumi 5 (pese) vjet eksperience pune në fushën e IT-së, e vërtetueshme me libreze pune; Nuk është përcaktuar qartë siç parashikohet në ligj organi që lëshon këtë certifikatë. Pra nga cili institucion kërkohet kjo certifikatë. Gjithashtu vjetërsia në punë kërkohet të vërtetohet me librezë pune, e cila nuk është dokument që lëshohet nga ndonjë institucion shtetëror por nga punëdhënësi. Gjithashtu kjo kërkesë bie ndesh me vetë mënyrën e kërkuar nga ju për vërtetimin e kësaj pike e cila citoj kërkon: Per te vertetuar kete pike operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim per numrin e punonjesve per periudhen Janar 2016 – Prill 2016, te shoqeruar me listepagesat e certifikuara nga organet tatimore, shoqeruar me diplomë/çertifikate, CV, kontrata te punës, per profesionet e kerkuara me siper [...]”Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar:

[...] Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij minimalisht 10 te punesuar ne te cilet te perfshihen specialistet me kualifikimet e meposhteme:

- te paktën 1 (një) person te certifikuar ne menaxhimin e projekteve PM (Project Management) te vertetuar me çertifikate perkatese. Menaxheri i projektit (pjesë e stafit) duhet të ketë minimumi 5 (pese) vjet eksperience pune në fushën e IT-së, e vërtetueshme me libreze pune;
- te paktën 3 (tre) Inxhinierë të diplomuar në njerën nga fushat e: Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike ose Teknologji Informacioni, 1(nje) Inxhinier ndertimi dhe 1(nje) Inxhinier/ specialist te certifikuar ne fushen e aspirim/kondicionimeve.

- *te paktën 1 (nje) teknik elektrik te pajisur me certificate per instalim elektrik;*
- *te paktën 1 (nje) person te certifikuar ne menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL - Information Technology Infrastructure Library) për menaxhimin e shërbimeve te Teknologjisë se Informacionit. Per kete te paraqitet çertifikata ITIL - Information Technology Infrastructure Library.*
- *te paktën 1 (nje) Inxhinier te diplomuar dhe te certifikuar për DBA (Database Administrator) për administrimin e bazës se te dhënave (do te vërtetohet me certifikatën përkatëse te dorëzuar)*
- *të paktën 1 (nje) specialist IT te certifikuar për Certified System Administrator për Menaxhimin e Sistemeve Operative si Microsoft, Linux, UNIX etj*
- *te paktën 2(dy) instalues tec ertifikuar per strukturimin e kablllove baker dhe fibres optike nga kompania prodhuese e tyre.*
- *të paktën 1 (një) specialist IT tëçertifikuar për ekspert të sigurisë në rrjet.*

*Per te vertetuar kete pike operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim per numrin e punonjesve per periudhen Janar 2016 – Prill 2016, te shoqeruar me listepagesat e çertifikuara nga organet tatimore, shoqeruar me diplomë/çertifikate, CV, kontrata te punës, per profesionet e kerkuara me siper. [...]*

III.2.2. Në nenin 46 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

*b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar pretendimeve të ngritura nga operatori ekonomik ankimes janë ngritur dy kërkitime të veçanta së pari në lidhje me llojin dhe natyrën e certifikatës e cila duhet dorëzuar dhe së dyti në lidhje me vërtetimin e eksperiencës së stafit teknik ( PM) me anë të librezës së punës. Në lidhje me kërkimin e parë, K.P.P. gjykon se synimi bazë i autoritetit kontraktor është disponueshmëria e stafit teknik të paktën një Project Management në funksion të realizimit të kontratës dhe në përputhje me parashikimet e nenit 46

pika 1 gërma “b” të LPP-së. K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejt pasi nuk ka përcaktuar emërtimin e institutit të trajnimit lëshues i certifikatës, duke lënë të hapur konkurrencën dhe në vlerësim të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të përzgjedhjes të institutit të trajnimit lëshues i certifikatës Project Management ( PM). Kërkesa e mësipërme e vendosur nga autoriteti kontraktor në cilësinë e kriterit të veçantë të kualifikimit shfaq trajtim të barabartë për ofertuesit shqiptar dhe të huaj. Duke marrë shkas nga objekti i procedurës së prokurimit objekt ankimi si edhe specifika e tij, K.P.P. gjykon se kërkesa e mësipërme është në proporcion me natyrën, përmasat e kontratës dhe objektin e procedurës së prokurimit.

III.2.4. Në lidhje me kërkimin e dytë të operatorit ekonomik ankimues se *Gjithashtu vjetërsia në punë kërkohet të vërtetohet me librezë pune, e cila nuk është dokument që lëshohet nga ndonjë institucion shtetëror por nga punëdhënësi*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në testin e proporcionalitetit të kriterit të mësipërm. Në lidhje me parimin e proporcionalitetit të parashikimit të mësipërm, K.P.P gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dylementëve kryesorë. Së pari nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin.

III.2.5. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues disponojnë në stafin e tyre një person te certifikuar ne menaxhimin e projekteve PM (Project Management) te vertetuar me çertifikate perkatese. Menaxheri i projektit (pjesë e stafit) duhet të ketë minimumi 5 (pese) vjet eksperience pune në fushën e IT-së, e vërtetueshme me libeze pune i cili duhet të plotësojë njëherazi dy kushte kumulative ( të jetë pjesë e stafit të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit kjo vërtetuar me anë të listëpagesave për periudhën e kërkuar dhe së dyti që të gëzojë eksperiencë 5 vjeçare në fushën e kërimit.. Për arritjen e synimit të tij, K.P.P. konstaton se autoriteti kontraktor krahas kërkesës së dorëzimit të dëshmive të kualifikimit të stafit teknik të kërkuar ka kërkuar dorëzimin e kontratave të punës si edhe listëpagesave të shoqërisë për periudhën Janar-Prill 2016 si edhe librezën e punës në funksion të vërtetimit të eksperiencës 5 vjeçare të kërkuar. Nga analiza e dy elementëve të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kërkesa e autoritetit kontraktor për dorëzimin e listëpagesave të shoqërisë për periudhën e kërkuar në funksion të plotësimit të kushtit të parë kumulativ ndërkohë kërkesa për dorëzimin e librezës së punës, si dokument me anë të të cilit vërtetohet ( dëshmohet eksperienca e individit- specialistit për periudhën e kërkuar dhe në përputhje me natyrën e eksperiencës së kërkuar, është një kërkesë propocionale. Referuar testit të sipërcituar të proporcionalitetit, kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk shkon përtej asaj çka është e nevojshme për të arritur synimin bazë, vërtetimin se operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë në stafin e tyre specialist sipas profilit të kërkuar, dhe se specialisti i kërkuar gëzon eksperiencë 5 vjeçare. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik se *librezë pune, e cila nuk është dokument që lëshohet nga ndonjë institucion shtetëror por nga punëdhënësi*, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në

pikën 3 të Vendimit Nr.70 datë 11.02.1999 të Këshillit të Ministrave “Për evidentimin e punëkërkesve të papunë”, parashikohet se “*Sherbimi Kombëtar i Punësimit nxjerr dhe pajis me librezë personale punësimi të tere punëmarresit, kliente të zyrave të punësimit dhe që e pranojnë një gjë të tillë. Ne librezën e punësimit shenohen nga punëdhësi dhe nga zyra kompetente e punësimit marrëdhëniet e punës së mbajtesit të librezës që nga rasti i leshimit të saj. Zyra kompetente e punësimit shenon në librezë profesionet, specializimet, kurset e kualifikimit dhe të dhëna të tjera, që kanë të bëjnë me formimin dhe aftësitë profesionale. Librezë qëndron e depozituar te punëdhësi gjatë tërë periudhës që vazhdojnë marrëdhëniet e punës.*”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se librezë e punësimit është mjeti ligjor i njohjes së eksperiencës së punësimit të stafit të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Nga ana tjetër K.P.P. konstaton se në asnjë rast operatori ekonomik ankimues nuk ka ngritur pretendime në lidhje me eksperiencën 5 vjeçare të specialistit të kërkuar.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se “[...] Në kërkesat e veçanta të kualifikimit është kërkuar: të paktën 3 (tre) Inxhinierë të diplomuar në njërën nga fushat e: Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike ose Teknologji Informacioni, 1(një) Inxhinier ndërtimi dhe 1(një) Inxhinier/ specialist të certifikuar në fushën e aspirimit/kondicionimeve të pakten 1 (një) teknik elektrik të pajisur me certificate për instalim elektrik; Kërkesa juaj për inxhinier ndërtimi nuk ka lidhje me këtë procedurë prokurimi pasi është e pakuptimtë dhe e tepërt. Përse duhet të kërkohet një inxhinier ndërtimi ndërkohë që vet tek specifikimet teknike nga ana juaj janë kërkuar kryerja e punimeve civile (pa përfshirë instalimet e specializuara). Mos vallë duhet një inxhinier ndërtimi për të kryer shembjen e murit. Në kërkesat tuaja të veçanta janë kërkuar tre inxhinier të fushave të inxhinierisë elektronike ose Teknologjisë Informacioni. Në këtë procedurë më shumë se 50 % të zërave në total i zë ndërtimi i “Data Center”. Si është e mundur që nuk është kërkuar asnjë teknik elektrik në momentin që kemi të bëjmë me zëra të tillë si sistem kondicioni, paneli elektrik, tokëzim punime të cilat kërkojnë prezencën e një inxhinieri elektrik dhe atij mekanik. Ju keni kërkuar 1 (një) inxhinier/specialist të certifikuar në fushën e aspirimit/kondicioneve. Në mënyrë të tillë që të mos krijohet keqinterpretim ju lutem përcaktoni qartë se çfarë lloji specialisti duhet në lidhje me fushën e aspirimit dhe kondicionimit. Kërkojmë të bëhet: “ Të paktën 3 ( tre) inxhinierë të diplomuar në njërën nga fushat; e Inxhinierisë elektronike, inxhinier informatike ose Teknologji Informacioni, 1 (një) inxhinier elektrik dhe 1 ( një) inxhinier Mekanik të certifikuar në fushën e aspirimit ( kondicionimeve). [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar:

[...] Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij minimalisht 10 te punesuar ne te cilet te perfshihen specialistet me kualifikimet e meposhteme:

- te paktën 1 (një) person te certifikuar ne menaxhimin e projekteve PM (Project Management) te vertetuar me çertifikate perkatese. Menaxheri i projektit (pjesë e stafit) duhet të ketë minimumi 5 (pese) vjet eksperience pune në fushën e IT-së, e vërtetueshme me libeze pune;
- te paktën 3 (tre) Inxhinierë të diplomuar në njerën nga fushat e: Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike ose Teknologji Informacioni, 1(nje) Inxhinier ndertimi dhe 1(nje) Inxhinier/ specialist te certifikuar ne fushen e aspirim/kondicionimeve.
- te pakten 1 (nje) teknik elektrik te pajisur me certificate per instalim elektrik;
- te paktën 1 (nje) person te certifikuar ne menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL - Information Technology Infrastructure Library) për menaxhimin e shërbimeve te Teknologjisë se Informacionit. Per kete te paraqitet çertifikata ITIL - Information Technology Infrastructure Library.
- te paktën 1 (nje) Inxhinier te diplomuar dhe te certifikuar për DBA (Database Administrator) për administrimin e bazës se te dhënave (do te vërtetohet me certifikatën përkatëse te dorëzuar)
- të paktën 1 (nje) specialist IT te certifikuar për Certified System Administrator për Menaxhimin e Sistemeve Operative si Microsoft, Linux, UNIX etj
- te pakten 2(dy) instalues te c ertifikuar per strukturimin e kablllove baker dhe fibres optike nga kompania prodhuese e tyre.
- të paktën 1 (një) specialist IT tëçertifikuar për ekspert të sigurisë në rrjet.

Per te vertetuar kete pike operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim per numrin e punonjesve per periudhen Janar 2016 – Prill 2016, te shoqeruar me listepagesat e çertifikuara nga organet tatimore, shoqeruar me diplomë/çertifikate, CV, kontrata te punës, per profesionet e kerkuara me siper. [...]

III.3.2. Në shtojcën 13 “Preventivi i Punimeve”, autoriteti kontraktor ka parashikuar kryerjen e punimeve si më poshtë vijon:

| NR | PËRSHKRIMI                    | NJËSIA | SASIA | CMIMI PA TVSH |
|----|-------------------------------|--------|-------|---------------|
| 1  | Punime Civile për Server Room | Njësi  | 1     |               |

|    |                                                                                             |              |            |  |
|----|---------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|------------|--|
| 2  | <i>FV Dysheme teknologjike</i>                                                              | <i>M2</i>    | <i>15</i>  |  |
| 3  | <i>FV Panele elektrik fuqie, përfshi intalimet elektrike të pajisjeve në Server Room,</i>   | <i>Njësi</i> | <i>1</i>   |  |
| 4  | <i>FV Sistem Kondicionimi</i>                                                               | <i>Copë</i>  | <i>1</i>   |  |
| 5  | <i>FV Rrjeti Elektrik (Kabllime,Kanaline Metalike, Tokezimi,Kuti Shperndarese Energjie)</i> | <i>Copë</i>  | <i>1</i>   |  |
| 6  | <i>FV Sistemi Akses Control</i>                                                             | <i>Njësi</i> | <i>1</i>   |  |
| 7  | <i>FV Sistemi mbrojtje zjarri dhe fikje me gaz</i>                                          | <i>Njësi</i> | <i>1</i>   |  |
| 8  | <i>FV Sistem Kamerash</i>                                                                   | <i>Njësi</i> | <i>1</i>   |  |
| 9  | <i>FV PDU te monitorueshme perfshire edhe sensoret e temperatures dhe lageshtise</i>        | <i>Copë</i>  | <i>4</i>   |  |
| 10 | <i>FV Veshje e dhomes se Serverave me izolues nxehtesia</i>                                 | <i>Copë</i>  | <i>1</i>   |  |
| 11 | <i>Sistemi i Menaxhimit</i>                                                                 | <i>Copë</i>  | <i>1</i>   |  |
| 12 | <i>FV Sistem Ndricimi per Dhomen e serverave</i>                                            | <i>Copë</i>  | <i>1</i>   |  |
| 13 | <i>FV Rack</i>                                                                              | <i>Copë</i>  | <i>2</i>   |  |
| 14 | <i>FV Pajisje e tipit tape library per backup</i>                                           | <i>Copë</i>  | <i>1</i>   |  |
| 15 | <i>FV Pajisje e tipit storage per Sistemin</i>                                              | <i>Copë</i>  | <i>2</i>   |  |
| 16 | <i>FV Pajisje siguri ne rrjet</i>                                                           | <i>Copë</i>  | <i>2</i>   |  |
| 17 | <i>FV Sëitch Ethernet</i>                                                                   | <i>Copë</i>  | <i>4</i>   |  |
| 18 | <i>FV Sëitch Fiber</i>                                                                      | <i>Copë</i>  | <i>4</i>   |  |
| 19 | <i>FV Server per bazen e te dhenave te tipit RDBMS te Sistemit</i>                          | <i>Copë</i>  | <i>2</i>   |  |
| 20 | <i>Ëëindoës Server 2012 Standart R2</i>                                                     | <i>Copë</i>  | <i>10</i>  |  |
| 21 | <i>Microsoft windows Exchange</i>                                                           | <i>Copë</i>  | <i>400</i> |  |
| 22 | <i>FV Server per aplikimin e Sistemit</i>                                                   | <i>Copë</i>  | <i>2</i>   |  |
| 23 | <i>FV Server per bazen e te dhenave te tipit RDBMS te Sistemit (Siti Sekondar)</i>          | <i>Copë</i>  | <i>1</i>   |  |
| 24 | <i>FV Server per aplikimin e Sistemit (Siti Sekondar)</i>                                   | <i>Copë</i>  | <i>1</i>   |  |
| 25 | <i>FV UPS 6KVA (Siti Sekondar)</i>                                                          | <i>Copë</i>  | <i>1</i>   |  |
| 26 | <i>FV UPS 30KVA me 30 min pavarësi</i>                                                      | <i>Copë</i>  | <i>2</i>   |  |
| 27 | <i>Sherbime Softëare</i>                                                                    | <i>Copë</i>  | <i>1</i>   |  |
| 28 | <i>Mirembajtje</i>                                                                          | <i>Vite</i>  | <i>2</i>   |  |

III.3.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është arritja e qëllimit të tij përmes procedurës së prokurimit objekt ankimi- ndërtimi *Data Center dhe Disaster Recovery*”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se referuar shtojcës 13 “*Preventivi i Punimeve*”, konstatohet se janë parashikuar si punime civile ashtu edhe furnizime të paisjeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe shërbime të lidhura me këto të fundit. Referuar paragrafit III.1- e vijues të arsyetimit të vendimit, Komisioni i Prokurimit Publik ka gjykuar se autoriteti kontraktor duhet të ndajë procedurën e prokurimit në dy lote të veçanta ose në dy procedura të veçanta. K.P.P. gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se kriteri i mësipërm i vendosur nga autoritetit kontraktor në drejtim të disponueshmërisë së inxhinierit të ndërtimit është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës ( referuar lotit/kontratës e cila lidhet me kryerjen e punimeve civile) dhe nuk është në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës ( referuar lotit/kontratës e cila lidhet me kryerjen e shërbimeve të lidhura me furnizimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e paisjeve të Teknologjisë së Informacionit). Sa më sipër, K.P.P. gjykon se në zbatimin e vendimit të K.P.P. autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë parashikimet e mësipërme.

III.3.5. Lidhur me kërkimin e dytë të operatorit ekonomik ankimues se “ [...] Si është e mundur që nuk është kërkuar asnjë teknik elektrik në momentin që kemi të bëjmë me zëra të tillë si sistem kondicioni, paneli elektrik, tokëzim punime të cilat kërkojnë prezencën e një inxhinieri elektrik

dhe atij mekanik.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar aktit administrativ nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 “*Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik*”, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se “*omississ.... Në vazhdim, në lidhje me pretendimin se “nuk duhet të jetë një teknik elektrik, por një inxhinier elektrik”, Autoritetit Kontraktor ka gjykuar dhe vlerësuar se vendosja e kriterit “për 1 (një) teknik elektrik të pajisur me certifikatë për instalime elektrike” i plotëson nevojat dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor për përmbushjen e zërave të kontratës dhe plotësimin e specifikimeve teknike. Kriteri, sic e kërkonte ju të ndryshohet, “për një inxhinier elektrikt”, do të kufizonte pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi duke pakësuar konkurrencën dhe duke ndikuar në barazinë e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik. Nga ana tjetër, në ankesën tuaj, ju nuk argumentoni se përse zërat si paneli elektrik, instalime elektrike, tokëzime etj., nuk mund të kryhen nga një teknik elektrik dhe duhet patjetër një inxhinier elektrik. Autoriteti Kontraktor gjykon që kërkesa/kriteri për kualifikim për 1 (një) teknik elektrik të pajisur me certifikatë për instalime elektrike” është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe jo diskriminues. Në lidhje me kriterin për një 1 (një) inxhinier/specialist në fushën e aspirim/kondicionimeve, kriteri është mjaft i qartë. [...]*” Në nenin 12 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “*Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij*”. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se është autoriteti kontraktor përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike dhe njëherazi përgjegjës për zbatimin e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit përfshirë edhe hartimin dhe vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret e veçanta të kualifikimit me kusht që këto të fundit të mos jenë në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi. Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar nevojën e stafit teknik të kualifikuar *inxhinier elektrik*, por ka parashikuar teknik elektrik te pajisur me certificate per instalim elektrik, K.P.P. gjykon se është autoriteti kontraktor përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit duke gjykuar si të arsyeshme vendosjen e minimumit të kualifikimit të stafit teknik ( specialist dhe jo inxhinier) dhe ndaj pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.3.6. Në lidhje me kërkimin e tretë të operatorit ekonomik ankimues se “*Autoriteti Kontraktor kërkon një inxhinier/specialist në fushën e kondicionimeve të certifikuar për të kryer këto shërbime dhe ky kriter nuk krijon asnjë keqinterpretim, pasi ky kriter do të quhet i plotësuar nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, mjafton që ai të ketë një person të punësuar, qoftë inxhinier apo specialist të certifikuar për sistem e aspirimit dhe kondicionimit. Referuar shtojces 12 të DST, si dhe Specifikimeve Teknike, ju bëjme me dije se për realizimin e kontratës për këtë procedurë nuk ka të parashikuar asnjë ze që mund të kërkojë pervojen apo aftësitë teknike të një inxhinieri mekanik. Duke qene se kjo procedure nuk parashikon punime apo shërbime të kësaj natyre, bazuar në nenet 26 dhe 28 të VKM nr. 914, si dhe në përputhje me parashikimet e nenit 46 të Ligjit “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, vlerësojmë se kjo*

*kerkese nuk eshte ne perputhje me natyren e kontrates. Për rrjedhojë ky pretendim i juaji nuk merret ne konsideratë.” K.P.P. vëren se në lidhje me kërkimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, lidhet me mbi sqarime mbi dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor.*

III.3.7. Në lidhje me kërkimin e operatorit ekonomik mbi sqarimet e kriterit të mësipërm të kualifikimit në drejtim të natyrës, llojit, emërimit dhe specifikës së certifikates/specializimit të kërkuar për tu dorëzuar nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në plotësim të kriterit të veçantë të kualifikimit të parashikuar në shtojcën 10 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, “*Kapaciteti Teknik*”, K.P.P. konstaton se kërkesa e autoritetit kontraktor se “[...]dhe 1(nje) Inxhinier/ specialist te certifikuar ne fushen e aspirim/kondicionimeve...[...] shfaq paqartësi. K.P.P. konstaton se autoriteti kontraktor, megjithëse referuar kthimit të përgjigjes për operatorin ekonomik ankimues ka sqaruar kërkesën e mësipërme, por nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton se nuk ka identifikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi sqarimet e mësipërme. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së duhet të sqarojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi kërkesën e mësipërme të vendosur si kriter i veçantë kualifikimi në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese pjesërisht qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se “[...] Në KVK është kërkuar: Operatori ekonomik duhet te paraqese Çertifikatat vetjake ISO 9001, ISO 18001, ISO 20000, ISO 27001 dhe BS PAS 99-2012. Në lidhje me kërkesën për certifikatë BS PAS 99:2012. Nuk ka standard BS PAS 99:2012 por vetëm BSI PAS 99:2012. Është ky standardi që ju i referoheni? BSI PAS 99:2012 është një standard i ri ndërkombëtar i cili lëshohet nga një i institut i vetëm ndërkohë që në botë ka standarde të tjera të cilat janë ekuivalente me të duke qenë se vetë standardi BSI PAS 99:2012 është një standard i cili përfshin standardet ISO të përcaktuara më sipër. Kjo kërkesë bie në kundërshtim me vetë ligjin pasi ul në mënyrë të ndjeshme konkurrencën midis operatorëve ekonomikë dhe përbën kërkesë certifikimi të dubluar në kërkesat për ISO. Nuk ka asnjë element që mbulon standardi ISO PAS 99:2012 i cili nuk mbulohet standarde e familjes ISO të cilat përdoren në çdo prokurim publik dhe janë referencë për të gjithë botën. [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 10 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar:

[...]Operatori ekonomik duhet te paraqese Çertifikatat vetjake ISO 9001, ISO 18001, ISO 20000, ISO 27001 dhe BS PAS 99-2012. [...]

III.4.2. Në nenin 46 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se *“Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.”*

III.4.3. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në zbatim të *lex specialis* Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka parashikuar në kriteret e veçanta të kualifikimit dorëzimin e certifikatave sipas standardit ndërkombëtar,(ISO) të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit me standardet e kërkuara të cilësisë. Në lidhje me kërkimin e operatorit ekonomik ankimes për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit në drejtim të dëshmisë se certifikimit PASS : 99:2012 Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se certifikimi i mësipërm është një standard britanik i hartuar dhe lëshuar nga British Standard Institute. Nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare të internetit të BSI, referuar specifikimeve të standardit të sipërcituar të hartuar nga BSI, sqarohet se *“Organizatat duhet të përdorin këtë PAS në lidhje me specifike kërkesat e standardeve të sistemit të menaxhimit p.sh. ISO 9001, ISO 14001, ISO / IEC 27001, ISO / IEC 22000, ISO / IEC 20000, ISO 22301 dhe OHSAS 18001 [...]”* Vetë autoriteti kontraktor referuar aktit administrativ nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 *“Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik”, inter allia* autoriteti kontraktor ka argumentuar se *BS PAS 99-2012”, është një certifikim i mirëfilltë ku integrohen shumë sisteme të menaxhimit dhe jo një udhëzues për integrimin e standardeve të ndryshme brenda një kompanie.*

III.4.4. Në lidhje me parimin e proporcionalitetit të kërkesës së mësipërme K.P.P gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë. Për arritjen e synimit të tij, K.P.P. konstaton se autoriteti kontraktor krahas kërkesës së dorëzimit të certifikatës ISO 9001, ISO 18001, ISO 20000, ISO 27001 ka kërkuar edhe certifikimin sipas standardit BS PAS 99-2012, si një standard i cili përfshin njëherazi edhe certifikimin për standardet e sipërcituara. Nga analiza e dy elementëve të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kërkesa e autoritetit kontraktor për dorëzimin e certifikimit BS PAS 99-2012 nuk është një kërkesë proporcionale pasi ky standard përfshin njëherazi edhe standardet e tjera të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Referuar testit të sipërcituar të proporcionalitetit, kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor shkon përtej asaj çka është e nevojshme për të arritur synimin bazë, vërtetimin se operatorët ekonomikë pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me standardet e kërkuara të

cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, në zbatim të nenit 46 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se “*[...]Në KVK është kërkuar: te paktën 1 (nje) person te certifikuar ne menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL - Information Technology Infrastructure Library) për menaxhimin e shërbimeve te Teknologjisë se Informacionit. Per kete te paraqitet çertifikata ITIL - Information Technology Infrastructure Library. Kërkesa juaj për një person të certifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA ( ITIL) për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë se informacionit është e tepërt pasi ajo nuk ka lidhje me asnjë nga zërat e kërkuar nga ana Juaj.[...]*” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 10 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar:

*[...]Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij minimalisht 10 te punesuar ne te cilet te perفشihen specialistet me kualifikimet e meposhteme:*

- *te paktën 1 (nje) person te certifikuar ne menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL - Information Technology Infrastructure Library) për menaxhimin e shërbimeve te Teknologjisë se Informacionit. Per kete te paraqitet çertifikata ITIL - Information Technology Infrastructure Library.*

*Per te vertetuar kete pike operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim per numrin e punonjesve per periudhen Janar 2016 – Prill 2016, te shoqeruar me listepagesat e çertifikuara nga organet tatimore, shoqeruar me diplomë/çertifikate, CV, kontrata te punës, per profesionet e kerkuara me siper. [...]*

III.5.2. Referuar aktit administrativ nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 “*Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik*”, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se “*[...]Per kete te paraqitet çertifikata ITIL - Information Technology Infrastructure Library, sqarojmë se:Duke ju referuar Shtojcës 12 të DST si dhe Specifikimeve Teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, i gjithë procesi i kërkuar në këtë procedurë prokurimi bazohet në Ligjin nr. 10 325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “Administrimi i Sistemit të bazave të të dhënave Shtetërore” dhe VKM-në nr. 710, datë 21 gusht 2013, “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”. Respektimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore të parashikuara në këto akte, kërkon domsdoshmërisht mirëmbajtjen e këtij sistemi që do të ndërtohet nëpërmjet personave/kompanive të certifikuar dhe të aftë ta kryejnë*

*këtë proces. Për këtë arsye Autoriteti Kontraktor kërkon me shumë të drejtë që në fazën e kualifikimit të ofertave të vlerësojë nëse operatorët ekonomikë ofertues e realizojnë këtë detyrim për përmbushjen me sukses të kontratës. Sipas Specifikimeve Teknike, pika 11 (faqe 14), Afati Kohor i Implementimit të Projektit është përcaktuar “Mirëmbajtje SLA 2 vjet”. Gjithashtu në pikën 9, “Mirëmbajtja”, kërkohet “Mirëmbajtja do të përfshijë shërbimet periodike sipas manualeve të pajisjeve dhe riparimin pa kosto në rastet e defekteve”. Duke qene se autoriteti kontraktor, si ze me vete te objektit te kesaj procedure prokurimi ka parashikuar edhe mirembajtjen, rrjedhimisht vleresojme se kriteri i siperkerkuar: “1 (nje) person te certifikuar ne menaxhimin e mirembajtjes dhe SLA (ITIL – Information Technology Infrastructure Library) per menaxhimin e sherbimeve te Teknologjise se Informacionit” eshte ne perputhje me natyren e kontrates.[...]”*

III.5.3. K.P.P. gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.5.4. Në lidhje me parimin e proporcionalitetit të parashikimit të mësipërm, K.P.P gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin.

III.5.5. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues disponojnë në stafin e tyre një *person te certifikuar ne menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL - Information Technology Infrastructure Library) për menaxhimin e shërbimeve te Teknologjisë se Informacionit. Per kete te paraqitet çertifikata ITIL - Information Technology Infrastructure Library.* Në lidhje me verifikimin nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit ( proporcionaliteti) K.P.P. gjykon se referuar “*Preventivit të Punimeve*” parashikuar në *Shtojcën 13* të dokumenteve të procedurës së prokurimit ndër të tjera është parashikuar edhe kryerja e shërbimit të mirëmbajtjes së paisjeve të Teknologjisë së Informacionit për të cilat shfaqet e nevojshme disponueshmëria e stafit teknik të kërkuar. Në lidhje me kërkimin e dytë nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj çfarë është e nevojshme ( volumi i kontratës), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se “[...]Në specifikimet e vendosura nga ana juaj për ambjentin ku do të ndihet Data Center kërkojmë përcaktimin nga ana juaj të: Ne çfare kati është dhoma? •Mungon nje plan vendosje e pajisjeve qe do te jene ne dhomes. Jepen permasat e dhomes por nga ana tjetër kerkohen qe t erezpektohen distancat. Kjo është e pamundur duke marre parasysh instalimin e te gjithë sistemeve qe kerkohen. • So do te kryhet futja e pajisjeve te renda si kondicioner, UPS, etj?• Kerkohet qe dhoma te jete dizenuar per te hostuar minimalisht 6 Rack. Me permasat e dhomes 450cmx318cm nuk është e mundur as per 6 Rack duke marre parasysh se pervec Rack-eve do te kete edhe pajisje te tjera si kondicionim, panele elektrike, system fikje zjarri, etj [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi para kërkesës mbi sqarime mbi dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor.

III.6.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar aktit administrative nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 “*Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik*”, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se “:Godina është ne rikonstrukcion te pjesshem per kete arsye nuk është e mundur ti bashkengjisim dokumentave standarte te tenderit planimetrine e objektit.Eshtë menduar qe Data Center te jete ne katin e pare te godines,ne momentin fillestar është planifikuar qe te vendosen 4 rack (1 ekzistues , 2 te rinj objekt I kesaj procedure dhe 1 RACK rezerve). • Plani i vendosjes se pajisjeve është lene i lire per sugjerim te Operatoreve Ekonomik • Per futjen e pajisjeve te renda si kondicioner,UPS etj është menduar qe dera te kete permasa me te medha se standarti AKSHI(105-120cm) por te jete 150cm. [...]. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se megjithëse autoriteti kontraktor ka sqaruar operatorin ekonomik ankimues në lidhje me pretendimet e tij të ngritura në lidhje me kërkesën e mësipërme, por nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton se nuk ka sqaruar operatorët e ekonomikë në lidhje me kërkimin e sipërcituar. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së duhet të sqarojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi kërkesën e mësipërme.

III.7. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se “[...]Në specifikimet teknike të vendosura nga ana Juaj për punimet civile kërkojmë përcaktimin nga juaj të: Punimeve Civile •Ju lutem percaktoni qarte se çfare do te perfshihet tek punimet civile?• Ne preventivin e dhene nga ana juaj është kerkuar FV Veshje e dhomes se serverave me izolues nxehtesie nderkohe qe tek faqja 18 e specifikimeve teknike është kerkuar e) Veshje te dyshemese dhe tavanit me material zjarrdurues. Duke qene se keto te dyja bien ndesh me njera tjetren ju lutme percaktoni qarte se kujt do ti behet veshja me izolues nxehtesie, gjithë dhomes se serverave apo vetem dyshemese dhe tavanit. • Referuar

*standarteve te AKSHI: Dera duhet te jete e permasave 105 – 120 cm e gjere dhe 240 cm e larte/ Ne document kerkohet qe te jete minimalisht 150cm e gjere dhe nuk jepet lartesi.Duhet te sakesohet nese pranohet dere sipas standarteve te AKSHI dhe nese duhet qe dera te jete e pajisur me dritare xhami. [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.7.1. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi para kërkesës për sqarime mbi dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor.

III.7.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar aktit administrative nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 *“Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik”, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se: “Ne lidhje me kete pretendim, ne dokumentat standarte te tenderit eshte shprehur qarte qe punimet civile perfshijne sa me poshte: a) Shëmbje muri;b) Demontim;c) Mbyllje hermetike të dritareve ;d) Derë kundra zjarrit;e) Veshje të dyshemesë dhe tavanit me material zjardurues ;f) Lyerja e dyshemesë me material izolues si dhe mureve deri ne lartësine 30 cm ;g) Bazamentë për kondicionimin ;h) Bazamentë për kondesatorët;i) Bazamentë për UPS-të;Veshje e dyshemesë dhe tavanit me material zjardurues eshte pjese e punimeve civile nderkohe qe zeri nr.10 i preventivit F.V Veshje e dhomes se Serverave me Izolues nga Nxehtesia perfshin vec te tjerave:Muret dhe ndarjet perreth Server Room-it do te jene ne gjendje te sigurojne izolim ndaj zhurmave mbi 40db dhe rezistente ndaj zjarrit deri ne 60 min.Ofertuesi do te instaloje nje dere aksesit te bollshme (te pakten 1.5m gjeresi) me karakteristikat e meposhtme;;a)Dritare xhami sigurie EN12600 Type B b) Zjarrdurues per 60 minuta;c) Me kycje elektromagnetike dhe mekanizem ristartimi;d)Ne rast nderprerje te energjise,te jete ne gjendje te hapet mekanikisht nga brenda Server Room-it pa patur nevojën e kartave te hyrjes apo energjise;Dera eshte kerkuar me permasa 150 cm per te lejuar lehtesimin e futjes se pajisjeve te renda dhe njesive te infrastruktures.” [...]”*

III.7.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se megjithëse autoriteti kontraktor ka sqaruar operatorin ekonomik ankimues në lidhje me pretendimet e tij të ngritura në lidhje me kërkesën e mësipërme, por nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton se nuk ka sqaruar operatorët e ekonomikë në lidhje me kërkimin e sipërcituar. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së duhet të sqarojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi kërkesën e mësipërme të vendosur si kriter i veçantë kualifikimi në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në lidhje me punimet civile, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në ri shpalljen e procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë qartësisht volumin e punimeve, natyrën dhe llojin e tyre në drejtim të punimeve civile.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se “[...] Në specifikimet teknike të vendosura nga ana Juaj për dysheme teknologjike Ne faqen 19 te specifikimeve teknike kerkohen: “Ne dy rreshtat ku do te vendosen raket do te jene te permasave 1000x600mm. Ju lutem vini ne dispozicion plan vendosja e pajisjeve per te pare se si eshte menduar konfigurimi I dyshemese. Ne faqen 20 te specifikimeve teknike eshte percaktuar qe Mbrojtja nga Zjarri: materilaet e ndertimit te klases DIN 4102 T1:A2 Zjarrrdruese te klases DIN 4102 T2: F30 ose F60.Standartet e vendosura me siper kufizojne shume numrin e prodhuesve te dyshemeve teknologjike. Ju lutem vendosni ne baze te ligjit fjalen **EKUIVALENTE** per standartet e mesiperme [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se

III.8.1. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi para kërkesës mbi sqarime mbi dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor si edhe mbi kërkesën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit.

III.8.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar aktit administrative nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 “*Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik*”, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se “:Ne lidhje me kete pretendim sqarojme se, plani i vendosjes se pajisjeve eshte lene ne dore te Operatorit Ekonomik.Ne rast se ka paqartesi eshte e mundur te kryhen vizita prane objektit deri ne momentin e hapjes se ofertave. Persa me siper ne baze te LPP Neni 23 pika 5, shtohet fjala “**OSE EKUIVALENTE**” per standartet e siperpermendura [...]. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se megjithëse autoriteti kontraktor ka sqaruar operatorin ekonomik ankimues në lidhje me pretendimet e tij të ngritura në lidhje me kërkesën e mësipërme, por nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton se nuk ka sqaruar operatorët e ekonomikë në lidhje me kërkimin e sipërcituar. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së duhet të sqarojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi kërkesën e mësipërme të vendosur në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.8.3. Në lidhje me kërkimin e dytë për modifikimin e dokumenteve të procedurës në drejtim të shtimit të *fjalës ekuivalent* K.P.P. konstaton se referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ autoriteti kontraktor ka pranuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues. Akoma më tej referuar *Shtojcës mbi ndryshimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit* publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, K.P.P. konstaton se autoriteti kontraktor ka ndryshuar kriterin si më poshtë vijon “-Ne faqen 20 te specifikimeve teknike ku eshte percaktuar “Mbrojtja nga zjarri: Materialet e ndertimit te klasës DIN 4102 T1: A2, Zjarrrdruesë të klasës DIN 4102 T2: F30 ose F60”, **shtohet fjala “ose ekuivalente”**. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se përsa kohë që kërkesa e mësipërme është pranuar nga autoriteti kontraktor nuk ka më objekt shqyrtimi mbi pretendimin e ngritur nga ana e operatorit ekonomik.

III.9. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se “[...] Në Nën specifikimet e vendosura nga ana Juaj për punimet elektrike kërkohet që furnizimi me energji elektrike të dhomës të bëhet nga dy linja të pavarura nga kabina kryesore e godinës. Ju lutem përcaktoni nëse këto kablo do të parashikohen nga kontraktuesi apo janë ekzistuese. Nëse po, sa është distanca nga kabina tek panelet elektrike të dhomës së serverave? [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se

III.9.1. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi para kërkesës mbi sqarime mbi dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor.

III.9.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar aktit administrative nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 “*Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik*”, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se “:Ne lidhje me kete pretendim sqarojme se, linjat e furnizimit dhe kabllo perkatese deri tek dhoma e serverit do jene ekzistuese [...]. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se megjithëse autoriteti kontraktor ka sqaruar operatorin ekonomik ankimues në lidhje me pretendimet e tij të ngritura në lidhje me kërkesën e mësipërme, por nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton se nuk ka sqaruar operatorët e ekonomikë në lidhje me kërkimin e sipërcituar. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së duhet të sqarojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi kërkesën e mësipërme të vendosur në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron

III.10. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se “*Ne lidhje me panelet elektrike:Ne specifikimet teknike panelet elektrike kerkohen Redundant Ne faqen 22 te ST Jepet nje skeme elektrike e cila nuk perputhet me kerkesat e dokumentit. Eshte nje skeme me nje burim furnizimi nga e cila furnizohen te gjitha pajisjet. Ne kete skeme eshte paraqitur vetem nje UPS. Pervet te tjerash kjo skeme nuk eshte e sakte persa i perket llogaritjes se numrit te automateve dhe kapacitetit te tyre. (p.sh: Automatet qe furnizojne PDU ne Rack).Ne faqen 22 te ST kerkohen Panele elektrik fuqie, Panel elektrik UPS.Ju lutem përcaktoni per keto dy panele skemen elektrike te sakte dhe pozicionimin e ketyre paneleve ne dhome pasi dhoma konsiderohet mjaft e vogel.*”

III.10.1. Në Specifikimet Teknike të dokumenteve të procedurës së prokurimit, konstatohet se autoriteti kontraktor, në faqen me numër rendor 22 ka parashikuar skemën e lidhjes së panelit si më poshtë vijon: “




Figura 6. Diagrama e panelit

- Panel elektrik fuqie
- Panel elektrik UPS
- Ndricimi, përfshi instalimet, celësat elektrikë, etj.
- Kanalinat rrjetë + Aksesorë për instalimet poshtë dyshemesë teknologjike, si dhe kanalinat metalike në tavan përfshi aksesoret përkatës (Tub Ø 25 mm + Aksesorë)
- F. V. Priza industriale 2P+T 32 A
- Instalimet elektrike për UPS-të, Kondicionerët, si dhe gjithë sistemet e tjera që do instalohen
- Tokëzimi
- Ndricimi emergjencës, etj.

III.10.2. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi para kërkesës mbi sqarime mbi dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor.

III.10.3. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar aktit administrative nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 “Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik”, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se “:Në lidhje me kete pretendim sqarojme se skema e panelit eshte e

sakte, redundanca do te behet nepermjet linjave paralele me change-over ekzistues. [...]. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se megjithëse autoriteti kontraktor ka sqaruar operatorin ekonomik ankimues në lidhje me pretendimet e tij të ngritura në lidhje me kërkesën e mësipërme, por nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton se nuk ka sqaruar operatorët e ekonomikë në lidhje me kërkimin e sipërcituar. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së duhet të sqarojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi kërkesën e mësipërme të vendosur në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.11. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se *“Ne lidhje me ndricimin: Faqe 34 e DST jane kerkuar FV Ndricimi Elektrik (Server Room) Kerkohen 8 ndricuesa fluoreshent 2x80W (starter elektronik) me shkalle mbrojtje IP45. Ndersa ne planimetri jane 6 cope. Ju lutem percaktoni qarte se sa duhet te jete numri I sakte I ndricuesve? Per ndricimin emergjent nuk eshte e qarte se si do te realizohet. Nevojitet nje shpjegim me I qarte.Persa i perket sistemit te furnizim vendosje ndricim elektrik, duke ju referuar projektit (figures) ndricuesi 9 eshte ndricimi i emergjences”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.11.1. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi para kërkesës mbi sqarime mbi dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor.

III.11.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar aktit administrative nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 *Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik”, inter allia* autoriteti kontraktor ka argumentuar se “ *“Persa i perket sistemit te furnizim vendosje ndricim elektrik, duke ju referuar projektit (figures) ndricuesi 9 eshte ndricimi i emergjences. [...].* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se megjithëse autoriteti kontraktor ka sqaruar operatorin ekonomik ankimues në lidhje me pretendimet e tij të ngritura në lidhje me kërkesën e mësipërme, por nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton se nuk ka sqaruar operatorët e ekonomikë në lidhje me kërkimin e sipërcituar. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së duhet të sqarojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi kërkesën e mësipërme.

III.12. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar ankesës së dorëzuar pranë këtij të fundit dhe ankesës së dorëzuar pranë autoritetit kontraktor operatori ekonomik ankimues nuk ka ngritur pretendime lidhur me kërkimet me numër rendor 12,13,17,18,19 si pretendime të ngritura pranë autoritetit kontraktor, pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se në rastin konkret ndodhemi përpara heqjes dorë nga ana e operatorit ekonomik ankimues mbi pretendimet e mësipërme ndaj nuk ka më objekt shqyrtimi.

III.13. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se se “Në specifikimet teknike të sistemit të menaxhimit është kërkuar:: Sistemi I menaxhimit Faqe 33 e ST: Pse duhet që sistemi të jete pajteter me ekran 12.9” me prekje? •

Faqe 33 e ST: Pse për një dhimë me sipërfaqe 15m<sup>2</sup> sistemi I menaxhimit duhet të jete me mundësi për të lidhur mbi 200 sensore? • Faqe 33 e ST: Kerkohet (sensoret duhet të lidhen me njëri tjetrin dhe me njesinë qendrore pa fije dhe në mënyrë wireless). Ju lutem çfarë nënkuptoni me këtë kerkese? • Referuar faqes 32 të ST është paraqitur integrimi I sistemit të detektimit dhe fikjes së zjarrit. Sipas këtyre specifikimeve janë shkelur rregullat ndërkombetare pasi sistemi I zjarrit është një sistem shumë sensitiv ndaj sigurisë së ambientit. Mund të integrohet vetëm kontrolli mbi zjarrin nëpërmjet sensoreve të timit ashtu si edhe gjendja e alarmit ose për alarmit, por nuk mund të bëhet aktivizimi apo caktivizimi I butonave për shuarjen e zjarrit. Kerkojmë që sistemi I zjarrit të mos integrohet në sistemin e menaxhimit. Në lidhje me sistemin e menaxhimit mund të integrohen vetëm sistemet e detektimit të timit dhe tre kontaktet për alarmet dhe prealarmet. • Referuar faqes 33 të ST: Portë hyrëse eireless të njesisë qendrore të sistemit të menaxhimit, është e paqarte, çfarë lloji portë është? •

Referuar faqes 33, specifikimet: “Procesor Intel Atom 1,6Ghz; 4GB MLC recovery Disc; 1 GB RAM; 2 GB SLC Hard Drive”, Përse është e nevojshme që të këtë aftësi programuese, madhësi të RAM dhe Hard drive të këtyre përmasave kur sistemi nuk mund t’i këtë të nevojshme këto vlera. (këto vlera janë shumë specifike dhe I perkasin sistemit të ndodhur në linkun: <http://ëëë.fibaro.com/en/the-fibaro-system/home-center-2> • Referuar faqes 33: “Mundësi për të integruar pajisje të prodhuesve të trete që përdorin protokoll komunikimi IP/KNX/zigbee/Zëave”. Këto specifikime kufizojnë mundësinë për integrimin e paleve të treat që mund të komunikojnë nëpërmjet protokolleve SNMP ose Modbus. Kerkojmë që të përfaqshihen edhe pajisje të paleve të treat të tjera që komunikojnë me anë të protokolleve Modbus dhe SNMP. • Specifikimet teknike të Modemi janë marrë copy paste nga linku me poshtë; <http://ëëë/netpromyanmar.net/index.php/products/product/vieë/5/344.html> Kerkojmë nga ana juaj ndryshimin e tyre në mënyrë që të bëjnë të mundur konkurrencën e hapur midis OE. Përse është e nevojshme që sensorit i temperaturës të masë temperaturë deri 100 gradë celsius, mund të mjaftohet edhe me 75 gradë celsius pasi nuk ka kuptim të arrihet këto limite? Dimensionet e sensorit janë shumë specifike: 65x28mm që të kufizojnë në gjetjen e këtij sensorit temperature nga prodhuesi të ndryshme. Kerkojmë heqjen e përmasave fikse të sensorit? Saktësia e sensorit të lagështirës është shumë e vogël (-0.03), përse kerkohet që të këtë një saktësi kaq precize? Nderkohe që pranohen edhe saktësi me të mëdha në vlerë, duke mos cenuar mifunksionimin e sistemeve në dhomen e serverave. Punimi I sensorit të ujit në temperature 100 °C nuk mund të pranohet sepse nuk ka kuptim që të këtë temperature të tilla në një dhomë serverash, rekomandohet që temperatura maksimale të arrihet të jete deri në 24°C. Referuar faqes 33, ku përshkruhet se Njesia Qendrore duhet të monitorojë levizjet nuk është e qarte: Se si duhet të bëhet detektimi I levizjeve, nëpërmjet kamerave apo nëpërmjet sensoreve. Gjithashtu çfarë kerkohet të bëhet në momentin e detektimit të levizjeve Komisioni i Prorurimit Publik vëren se:

III.13.1.Në lidhje me kërkimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi para kërkesës mbi sqarime mbi dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor.

III.13.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar aktit administrative nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 “[...] *Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik*”, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se “ *“Sistemi është menduar me madhësi 12.9” me prekje që të jete i dukshëm dhe praktik në përdorim. -Sistemi i menaxhimit duhet të ketë mundësi për të lidhur mbi 200 sensore për sipërfaqen 15 m<sup>2</sup>, pra është lapsus. Ishte 2000 sensore Behet 200 sensore - Sensorët duhet të lidhen me njëri tjetrin dhe me njësinë qendrore në mënyrë ëreless për arsye që të mos jete e nevojshme instalimi i sistemit të kabllimit për sensorët dhe për të lejuar riorganizim të lehtë të mbulimit me sensore në të ardhmen. -Kërkesa që sistemi i fikjes së zjarrit të mos integrohet në sistemin e menaxhimit pranohet megjithatë sistemi i menduar e suporton këto karakteristika. Ishte Integrim i sistemit të dedektimit dhe fikjes së zjarrit.Behet Integrim i sistemit të dedektimit të zjarrit. -Porte hyrëse ëreless do të thotë porte komunikimi ëreless për të lejuar komunikimin me sensorët. -Specifikimet janë kërkuar të përmasave që lejojnë performancë sa më të lartë të sistemit. -Shtohet fjala "ose ekuivalent" sipas ligjit.-Shtohet fjala "ose ekuivalent" sipas ligjit. -Sensori i temperaturës është kërkuar të mase temperature deri 100 grade celsius për të lejuar sensorin të dergojë informacion edhe në kushtet e një zjarri të mundshëm. -Pranohet kërkesa për heqjen e përmasave të sensorit.-Pranohet kërkesa për heqjen e saktësisë së sensorit të lageshtirës duke lejuar saktësinë deri sa të lejohet mirefuksionimi i sistemeve në dhomen e serverave.-Dedektimi i levizjeve do të behet nepermjet kamerave të cilat bëjnë snapchat në momentin e levizjes. Ky snapchat mund të dergohet për njoftim me email gjithashtu mund të përdoret për sinkronizim me sistemin e aksesit me ane të databazës.. [...]. Akoma më tej, referuar “Shtojcës për modifikimin e dokumenteve të tenderit” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentet e procedurës së prokurimit si më poshtë vijon:*

*-Në faqen 32 të specifikimeve teknike, Sistemi I Monitorimit me Kamera, **hiqet pjesa:***

*“Gjithashtu ky sistem është përgjegjës për monitorimin e:*

- 1. Temperatures*
- 2. Lageshtires*
- 3. Prezences se ujit”*

*-Në faqen 32 të specifikimeve teknike, Sistemin e detektimit dhe fikjes së zjarrit, kudo ku përmendet “Sistemi i dedektimit dhe fikjes së zjarrit” behet **“Sistemi i dedektimit të zjarrit”***

*-Në faqen 33 të specifikimeve teknike të sistemit të menaxhimit, Njesia Qendrore, pjesa “Mundësi për të lidhur mbi 2000 sensor” behet **“Mundësi për të lidhur mbi 200 sensor”**.*

*-Në faqen 33 të specifikimeve teknike të sistemit të menaxhimit, Softi i menaxhimit, të pjesa “Mundësi për integruar pajisje të prodhuesve të trete që përdorin protokoll komunikimi*

*IP/KNX/zigbee/Zëave”, shtohet fjala “ose ekuivalente”*

*-Ne faqen 34 te specifikimeve teknike te sistemit te menaxhimit, Modemi, shtohet fjala “ose ekuivalente”*

*-Ne faqen 34 te specifikimeve teknike te sistemit te menaxhimit, Sensori i Temperatures, hiqen pjeset:*

*“Saktesia matese: 0,5°C*

*Dimensions (Diameter x Height): 65 x 28 mm”*

*-Ne faqen 40 tek pjesa “18. FV Sëitch Fiber FC -4 (kater) cope (dy per secilin site)” shtohet fjala “ose ekuivalente”*

*-Ne faqen 42, pika, “19. FV Server per bazen e te dhenave te tipit RDBMS te Sistemit - 2 (dy) cope” pjesa “Minimumi 4 CPU – 175030” behet “Minimumi 4 CPU – Benchmark 17503”*

*-Ne faqen 44 te specifikimeve teknike te UPS, pika “23. FV UPS 6KVA (Siti Sekondar)” shtohet fjala “ose ekuivalente”*

III.13.4. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor, pas trajtimit të ankesës ka pranuar pretendimet e sipërcituara të operatorit ekonomik ankimues dhe njëherazi ka publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit dhe sa më sipër K.P.P. gjykon se nuk ka objekt shqyrtimi për kërkimet e mësipërme.

III.14. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se se “Në specifikimet teknike të sistemit të menaxhimit është kërkuar:: Sistemi i menaxhimit Faqe 33 Në specifikimet teknike të RACK ju lutem përcaktoni: Sa Rack ekzistues jane?Me cfare permasash?Tek specifikimet teknike nuk eshte percaktuar Pika (13. FV Rack -3 (Kater) cope+ aksesore kabllimi (dy per site primar +1 per site sekondar) nderkohe qe tek preventive i punimeve jane kerkuar 2 Rack.Ju lutem percaktoni sa Rack kerkohen 2 cope, 3 cope,4 cope?Ju lutem percaktoni cfare tipi Rack-u (Dimensionet)” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.14.1. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi para kërkesës mbi sqarime mbi dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor.

III.14.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar aktit administrative nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 *Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik”, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se “ Persa me siper sqarojme se RACK-et do jene RACK Serverash 42U. Sasia do jete 4 rack (1 ekzistues), 2 te rinj, objekt i kesaj procedure dhe 1 RACK reserve (ekzistues).” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se megjithëse autoriteti kontraktor ka sqaruar operatorin ekonomik ankimues në lidhje me pretendimet e tij të ngritura në lidhje me kërkesën e mësipërme, por nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton se nuk ka sqaruar operatorët e ekonomikë në lidhje me kërkimin e sipërcituar. Sa më sipër, K.P.P.*

gjykon se autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së duhet të sqarojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi kërkesën e mësipërme të vendosur në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.15. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se se *“Sistem alarmi: Në faqen 32 Ne lidhje me Sistemet e Alarmit. Ne faqe 32 te specifikimet teknike kerkohet Sistem Alarmi nderkohe ne Faqen 13 ku eshte tabela permbledhese nuk eshte parashikuar per tu instaluar. Duhet te sakesohet nese do te kete apo jo Sistem Alarmi* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.15.1. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi para kërkesës mbi sqarime mbi dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor.

III.15.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar aktit administrative nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 *“Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik”*, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se *“Per sa me siper, sqarojme se Sistemi i alarmit eshte kerkese per kete procedure prokurimi, dhe se eshte kerkuar te jete pjese integrale e sistemit te menaxhimit.”* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se megjithëse autoriteti kontraktor ka sqaruar operatorin ekonomik ankimues në lidhje me pretendimet e tij të ngritura në lidhje me kërkesën e mësipërme, por nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton se nuk ka sqaruar operatorët e ekonomikë në lidhje me kërkimin e sipërcituar. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së duhet të sqarojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi kërkesën e mësipërme në respekt të parimit të transparencës parashikuar nga neni 1 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”* të ndryshuar.

III.16. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se *“Sistemi C CTV Ne specifikimet teknike eshte kerkuarKamerat IP duhet te jene 2MP(1930x1088)pixel,Video Frame Rate- 25fps@1080P, minimuni I aktivizimit te ndricimit IR eshte 0.02Lux/F2.0, 0Lux IR on,Maksimuni I ndricimit IR eshte 30m,Lentja fokale 3.6mm me kend shikimi te pakte 89.9°,te ushqehet me tensin 12v,shkalla e mrojtje IP67-IK10,Procesori te jete 1/2.7" 2Megapixel CMOS-Keto jane specifikime teknike te cilat te gjitha sebashku dhe sidomos Feature 1/2.7" 2Megapixel CMOS, Lentja fokale 3.6mm me kend shikimi shkalla e mrojtje IP67-IK10 i referohet nje brand te vetem qe eshte DAHUA DH-IPC-HDBE4221E(-AS-)-Perse duhet qe kamera te jete IP67 (qe eshte mbrojtja kunder ujit kur kamerat bien ne regjim zhytje ne uje) nderkohe qe kamerat do te instalohen ne ambjentet e brendshme te Data Centerit?Gjithe bota perdor standartin IP66 per kamera outdoor.Ju po kerkoni IP67 per kamera*

indoor.Kjo eshte nje kerkese disproporcionale me qellimin e perdorimit.Kerkojme:-Ndryshimin e specifikimeve teknike dhe perpilimi i tyre ne menyre qe te sigurojne konkurrencen e hapur midis Operatoreve Ekonomik.-Heqjen e kerkeses per standart IP66 ose zevendesimin e saj me nje standart me te uletKomisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.16.1. Në shtojcën “Specifikimet Teknike” të pocedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar si më poshtë vijon:

Kamerat IP duhet te jene 2MP(1930x1088)pixel,Video Frame Rate- 25fps@1080P, minimuni I aktivizimit te ndricimit IR eshte 0.02Lux/F2.0, 0Lux IR on,Maksimuni I ndricimit IR eshte 30m,Lentja fokale 3.6mm me kend shikimi te pakte 89.9°,te ushqehet me tensin 12v,shkalla e mrojte IP67-IK10,Procesori te jete 1/2.7" 2Megapixel CMOS

III.16.2. Në nenin 23 pika 1,2 dhe 3 dhe 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se :

*“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;*

*b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj.*

*5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”*

Gjithashtu në nenin 27 “Kontratat e Mallrave” pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë

*minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.[...]*”

Në nenin 30 të *lex specialis* Ligjit për Prokurimin Publik parashikohet se: “[...]Procedura e hapur është procedura e preferuar në prokurimet.”

III.16.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27 pika 1 e aktit normative në zbatim të ligjit VKM nr.914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik ( në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e specifikimeve teknike.

III.16.4. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik se kasa mbrojtëse e kamerës duhet të ketë të njëjtin nivel mbrojtje më të ulët lidhjet e tjera të sistemit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është e drejtë e autoritetit kontraktor, i cili në varësi të ekspozimit me mjedis të secilës prej elementëve të sistemit të përcaktojë edhe nivelin e mbrojtjes, referuar sistemit kombëtar, ndërkombëtar apo të kombinuar. Referuar shtojcës “*Specifikimet Teknike*” autoriteti kontraktor ka parashikuar në lidhje me sistemin e kamerave si më poshtë vijon “*Për ruajtjen fizike dhe mbikqyrjen e ambientit duhet të instalohet një sistem Monitorimi me kamera. Në total do të instalohen 3 kamera IP. Të gjithë kamerat do të lidhen në rrjetin ethernet dhe sigurohet ruajtja e imazheve për një periudhë 1 mujore. Sistemi duhet të japë alarme dhe të sinjalizojë në rast se ndonjë nga kamerat del jashtë funksioni.Dy kamera do te instalohen ne amjetin e brendshem,ndersa nje kamer do te jete ne abjetin e jashtem te Serverit,ne menyre qe te shikojte porten hyrese te tij.*” Në rastin konkret, K.P.P. konstaton se referuar procedurës së prokurimit objekt ankim, ekspozimi në mjedis i kamerave është i ulët ( kamera të instaluar në mjedise të mbyllura) ndaj dhe vendosja e nivelit të mbrojtjes së kasës së kamerave IP 67 ( Ingress Protection 6-Mbrojtur nga pluhuri, hyrje e kufizuar (asnjë depozitë të dëmshme) 7-Mbrojtja kundër efektit të zhytjes mes 15cm dhe 1m) . Sa më sipër K.P.P. gjykon se për shkak të ekspozimit të paktë në mjedis të jashtëm të sistemit të kamerave kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk është në përputhje me nenin 27 pika 1 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” të ndryshuar.

Sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.17. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se se “*Ne lidhje me sherbimin Softëare.Tek Sherbimi Softëare ju lutem sqaroni1.*”Transferimi i te dhenave do te kryhet ne momentin qe serverat qendror te database

*eshte bere Virtualizimi I Serverave te Siperpermendur”Duhet te sqarohet nese Virtualizimi I Serverave do te behet nga kompania apo nga vete Autoriteti Kontraktor.2.Te pikat ku pershkruhet mirembajtja mujore, ne piken “e” thuhet “Te kryeje mirembajtje proactive”.Ju lutem sqaroni cfare nenkuptoni me mirembajtje proactive dhe cfare perfshihet ne te?Persa me siper grupi i punes gjykon se specifikimet teknike jane mese te qarta mbi kerkesat qe ka autoriteti kontraktor mbi transferimin e te dhenave dhe mirembajtjen. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.17.1. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi para kërkesës mbi sqarime mbi dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor.

III.17.2. Në shtojcën “*Specifikimet Teknike*” të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se : “*Ne shërbimet softëare perfshihen te gjithë punimet qe kane te bejne me transferimin e sistemeve aktuale ne serverat e rinj qe do te levrohen ne kete prokurim. Fillimisht do te behet testimi i te gjithë posteve te punes per te garantuar nje mjedis te gatshem per pune ne te gjithë zyrat. Ketu perfshihet identifikimi dhe etiketimi i te gjithë posteve te punes. Te gjithë te dhenat qe jane ne sistemet akutual duhet te transferohen ne serverat e rinj.Transferimi i databazave te sistemeve:*

*NAVISION*

*FINANCE*

*DOMAIN CONTROLLER*

*EXHCANGE MAIL SERVER*

*Transferimi i te dhenave do te kryhet ne momentin qe ne serverat qendror te databaze eshte bere virtualizimi i Serverave te Siperpermendur.Autoriteti Kontraktor kerkon qe sistemet te mos ndalojne punen per asnje moment.*

*Ne pjesen e Network duhet te analizohen te gjithë VLAN dhe Rules qe jane aktualisht ne Fireëall dhe me pas te krijohen VLAN te rinj sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor.*

*Mirëmbajtjen hardware për të gjithë infrastrukturën e serverave.*

*Mirëmbajtjen 8x5 që përfshin kohë përgjigje brenda 4 orësh, nëse suporti remote nuk jep rezultat.*

*Analizimin e “event log-eve” për çdo server dhe ndërmarrjen e veprimeve përkatëse për të fiksuar problemet e mundshme.*

Kompania duhet të krijojë / diskutojë me perfituesin e shërbimit -n një axhendë periodike kontrollesh si më poshtë:

1. Mujore
  - a. Kontroll i logeve të serverave
  - b. Kontroll i statistikave të storage (Used disk space etc)
  - c. Kontroll i statistikave për programe
  - d. Kontroll i disqeve për problem në rast nevojë
  - e. Të kryejë mirëmbajtje proaktive.
2. 3 Mujore.
  - a. Testim / kontroll i kompletuar i pjesëve me kritike të infrastrukturës së klientit
  - b. Kontroll i detajuar i gjithë log-eve hardëare / softëare
  - c. Rishikim i të dhënave mbi performancë e serverave
  - d. Rekomandime për upgrade të mundshme hardëare

III.17.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar aktit administrative nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 *Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik*”, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se “*Persa me siper grupi i punes gjykon se specifikimet teknike jane mese te qarta mbi kerkesat qe ka autoriteti kontraktor mbi transferimin e te dhenave dhe mirembajtjen.* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të drejtë pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues. Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstatohet se në asnjë rast autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar të dhëna të detajuara në lidhje me procesin e Virtualizimit të Serverave ndërsa në termat e shërbimit Të kryejë mirëmbajtje proaktive shfaqet paqartësi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë qartë natyrën e shërbimeve që do të kryhet nga ana e operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.18. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se se “*Ne lidhje me sistemin HVAC. KerkohetSistemet Ngrohje/Ventilim/Kondicionim (HVAC)Kerkohet sistemi i kondicionimit/ajrimit (HVAC) do te kete fuqi konsumi minimalisht 5-5.4 KË per shkak se per kete dhome nevojitet nje kondicioner me i madhe se ceshte percaktuar me poshte (kapacitetit total te ftohjes, nga 5.4 kË ne 6kË) athere edhe kapacitetit konsumit te energjiise do te ndryshoje.-Tek specifikimet teknike eshte kerkuar qe secila perj njesive duhet te jete e pajisur me 2 kompresore spiral si me poshte:Kompresore te mund te jene spiral por jo spiral dixhital sepse ky lloj (digital scroll) eshte copy ërite iEmerson. Duke qene se ligji I prokurimeve publike ndalon dhenien e specifikimeve teknik te cilat te cojne drejt nje brand te vetem kerkojme heqjen e kerkeses per (digital scroll)Tek specifikimet teknike kerkohet qe:Ushqimi per cdo njesi duhet te jete 230V,1 fazor,50Hz. Per shkak se kondicioni nevojitet kapacitet me I madh se cfare eshte kerkuar atehere edhe ushqimi duhet me I madh.*

400V/3Ph/50HZ Tek specifikimet teknike percaktohet qe: Cdo qark ftohes duhet te kete valvulen e zgjerimir termal, filtrimin e thate, depozite per lengun ftohes, valvulen kyce te sigurise. Kompresori duhet te jete I montuar mbi nje bazament per te parandaluar transmetimin e dridhjeve tek njesia. Cdo qark ftohes duhet te jete I lidhur e nje kondensator qe mund te kontrollohet ne distance dhe te jete I lidhur me instalimin e kondensatorit. Largesia maksimale 50 meter. Ne kete pike nuk percaktohet madhesia dhe volumi I depozites per lengun e ftohesit. Duhet te dihet edhe lartesia ndermjet njesise se jashtme dhe asaj te brendshme. Kerkojme te sqarohen si me poshte: A) Faqe 22 e ST kerkohet: Sistem ngrohje/ventilim/kondicionim (HVAC) Kerkohet system ngrohje/ventilim/kondicionim apo system ftohje percizionit te larte? B)

Faqe 22: (Autoriteti Kontraktues) ka perlllogaritur qe sistemi I kondicionimit/ajrimit (HVAC) do te kete nje fuqi konsumi minimalisht 5-5.4KË; C) Faqe 23: Kerkohet certificate Testimi per kondicionimin. Kjo certificate jepet nga fabrika pasi eshte prodhuar pajisja. A do te pranohet ne ofertim vetem Deklarate Konformiteti? D) Sa eshte kapaciteti ftohes ne kË I nje pajisje? E) Sa eshte nxehtesia qe clirojne pajisjet ekzistuese? F) A kerkohet system ventilimi per dhomen? G) Ku eshte menduar te vendoset kondensuesi I kondicionerit? H) Sa eshte distance nga kondicioner tek kondensuesi? I) Sa eshte disniveli (lartesia) ndermjet kondicionerit dhe kondensuesit? Per sa me siper, sqarojme se sistemi i kondicionimit/ajrimit (HVAC) do te kete fuqi konsumi minimalisht 5-5.4KË sic eshte specifikuar ne faqen 22. Kompresoret duhet te jene spiral dhe redundant, me ushqim per cdo njesi 230V, 1 fazor 50Hz. Per kerkesat tuaja nga pika A deri ne piken I, sqarojme se zgjidhja eshte lene ne dispozicion te Operatoreve ekonomik, sipas produkteve qe do sjellin. Duhet te respektohen permasat e Server room. Per cdo paqartesi eshte e mundur te kryhen vizita prane objektit deri ne momentin e hapjes se ofertave”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.18.1. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi para kërkesës mbi sqarime mbi dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor

III.18.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar aktit administrative nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 “*Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik*”, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se “Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar aktit administrative nr. 13335/1 Prot, datë 15.06.2016 “*Trajtim i ankesës së operatorit ekonomik*”, inter allia autoriteti kontraktor ka argumentuar se “Per kerkesat tuaja nga pika A deri ne piken I, sqarojme se zgjidhja eshte lene ne dispozicion te Operatoreve ekonomik, sipas produkteve qe do sjellin. Duhet te respektohen permasat e Server room. Per cdo paqartesi eshte e mundur te kryhen vizita prane objektit deri ne momentin e hapjes se ofertave ” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se megjithëse autoriteti kontraktor ka sqaruar operatorin ekonomik ankimues në lidhje me pretendimet e tij të ngritura në lidhje me kërkesën e mësipërme, por nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton se nuk ka sqaruar operatorët e ekonomikë në lidhje me kërkimin e sipërcituar. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor në zbatim

të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së duhet të sqarojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi kërkesën e mësipërme në respekt të parimit të transparencës parashikuar nga neni 1 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.*

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuse qëndron

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri:

#### **Vendos**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions” shpk për procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur”* me nr. REF-39933-05-30-2016 me objekt *“Ndërtim i një ”Data Center” dhe ”Disaster Recovery” ( dublikim të dhënash) në ambientet e UKT sha”* me *fond limit 70,011,675 lekë pa TVSH*, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 23.06.2016 nga autoriteti kontraktor Ujësjetës Kanalizime Tiranë, Sh.a
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor, me rishpalljen e procedurës së prokurimit, të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomikë “Advanced Business Solutions” sh.p.k
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1458 Protokolli; Datë 17.06.2016**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Spiro Kuro**

**Anëtar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Kryetar**  
**Gentian Këri**